



MIRË SE VJEN o muaj i Ramazanit



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXIII i botimit
Nr. 03 (490)
Mars, 2024

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Mirë se vjen o muaj i Ramazanit / Mehmet Disha

6 Ramazani, muaji i ripërtëritjes shpirtërore / H. Bujar Spahiu

8 Lajme / Aktivitete



12 Agjërimi në histori dhe Ramazani në prizmin Islam / Dorian Demetja

14 Pasimi i shkaqeve dhe Dhulkarnejni / Mehmet Ates

18 Gruaja u nderua me Islamin / Fatma Karaj

20 Jurisprudenca e agjëritimit / Redaksia

22 Profeti Muhamed (a.s.) dhe të rinjtë: Kuptimi i jetës / Abdullah Bulku

26 Disa mesazhe nga rinia e profetit Ibrahim (a.s.) / Tauland Bica

28 Halid Bin Uelidi pranon Islamin / M. Jusuf Kandeheui



30 Rëndësia e namazit të Teravisë / Eduart Demiraj

34 Hafiz Ismet Dibra (1886-1995) / Personalitet

36 Të mirat shëndetësore të agjëritimit / Erion Sukaj



Mirëse vjen **o muaj i Ramazanit**



Ramazani është pranverë e jetës së besimtarit. Jemi së bashku në prag të muajit të agjërimit, i cili është ripërtëritësi i energjisë shpirtërore. Është muaji i faljes dhe i mëshirës, në të cilin Allahu i Lartësuar i dhuron amnistinë e Tij hyjnore besimtarëve.

Për jetën e individit, familjes dhe shoqërisë islame, Ramazani shfaqet si një muaj i veçantë, të cilin mund ta emërtojmë si pranvera e jetës islame, sepse përgjatë tij ripërtërihet jeta në tërësi, ripërtërihen mendjet me njohuri, ripërtërihen zemrat me besim e devotshmëri, ripërtërihet shoqëria me unitet e harmoni.

Ramazani është një nga periudhat më të rëndësishme të mirësisë dhe begatisë hyjnore, sepse në të pastrohen e lartësohen shpirtat, afrohen zemrat te Krijuesi i tyre, hapen dyert e xhenetit dhe mbylleen dyert e xhehenemit.

Është kjo mirëseardhje sublimë qiellore ndaj muajit të Ramazanit, që tregon se ky muaj gëzon një pozitë të lartë në sistemin islam të jetës.

Rituali i agjërimit që kryhet gjatë këtij muaji është i karakterizuar me vlera morale, shpirtërore e edukative unike dhe është pikërisht ky sistem i vlerave, i kristalizuar në këtë adhurim, i cili simbolizon urtësinë hyjnore të Krijuesit të gjithësisë.

Ja se si përshkruhet në Kur'an dispozita obliguese e këtij rituali: "O ju që keni besuar, ju është obliguar agjërimi ashtu siç u ishte obliguar dhe paraardhësve tuaj, që të bëheni të devotshëm." (Bekare, 183)

Zoti i Madhëruar përshkruan në Librin e Tij urtësinë e obligimit të agjërimit dhe rëndësinë e tij. Ajo fshihet në shfaqjen e devotshmërisë. Është pikërisht kjo një ndër vlerat, dobitë dhe sekretet e legjislacionit islam, që të bindemi se ai është hyjnor, i përherëshëm, i shpallur vetëm për të realizuar interesin e njerëzve dhe për të mënjeluar rreziqet, dëmet dhe pasojat që mund të shfaqen në jetën e tyre.

Nën optikën e traditës profetike le të përshkruajmë se si Profeti a.s. u ligjëronte besimtarëve mbi rëndësinë, vlerat, mirësitë dhe begatitë e këtij muaji. Transmetohet se në ditën e fundit të muajit Shaban dhe në prag të muajit Ramazan, profeti Muhamed a.s. ka ligjëruar përpara besimtarëve duke thënë: "O njerëz, është afruar një muaj fisnik dhe i begatshëm, në të cilin gjendet Nata e Kadrit, që vlerësohet si më e mirë se një mijë muaj. Agjërimin e tij Zoti e bëri obligim dhe faljen e teravisë e bëri të pëlqyeshme. Ai që gjatë këtij muaji kryen një obligim fetar, shpërblehet sikur ka kryer shtatëdhjetë të tillë, e

ai që kryen një punë vullnetare, shpërblehet sikur ka kryer një detyrë fetare. Ky është muaji i durimit dhe durimi shpërblehet me xhenet. Ky është muaji i barazisë dhe i shtimit të furnizimit (rizikut) të besimtarit; ai që ushqen një agjërues i falen mëkatet, shpëton nga zjarri dhe nuk i pakësohet shpërblimi." Njerëzit i thanë: "O i Dërguar i Zotit, nuk mundet çdokush prej nesh të ushqejë ndonjë agjërues", kurse ai tha: "Zoti e shpërblen atë që ushqen agjëruesin qoftë edhe me një hurmë, ujë ose qumësht."

Në një tjetër hadith Profeti a.s. i është drejtuar kështu besimtarëve: "O njerëz. Ju ka ardhur muaji i Allahut të Madhëruar, muaji i begative, mëshirës dhe faljes, muaji më i lartë tek Allahu. Ditët e këtij muaji janë më të vlefshmet, netët e këtij muaji janë më të mirat, orët e këtij muaji janë më të bekuarat. Është muaji në të cilin jeni të ftuar tek Allahu si miqtë më të respektuar të Tij. Është muaji në të cilin shikimi është lartësim i Allahut dhe gjumi është adhurim, është muaji kur pranohet lutja dhe shumëfishohet shpërblimi për veprat. Kërkon, pra, me zemër të pastër dhe qëllim të sinqertë bekimet e Allahut për mbajtjen e agjërimit gjatë këtij muaji dhe lexoni Kur'an për hir të Tij. Atij që i mohohet falja e mëkateve në këtë muaj, është njeriu më i pafat. Uria dhe etja e këtij muaji le t'ju sjellin ndërmend urinë dhe etjen e Ditës së Kiametit..."

Duke medituuar në porosinë profetike, çdo besimtar duhet të vlerësojë parimet e etikës islame. Profeti Muhamed a.s. gjatë muajit të Ramazanit e shtonte adhurimin. Ai ishte më zemërgjerë se njerëzit e tjerë dhe veçanërisht gjatë Ramazanit. Gjatë këtij muaji ai shtonte bamirësinë, leximin e Kur'anit, namazin dhe përmendjen e Allahut.

Në këtë mënyrë ai i inkurajonte besimtarët në lutje e adhurim, i mbushte zemrat e tyre me begatitë që dërgoheshin ato ditë dhe i frymëzonte shpirtat me të mirat e agjërimit.


Përgatituni, pra, o besimtarë për muajin e Ramazanit. Edukohuni me edukatën e tij dhe fitoni dobi prej urtësive dhe sekreteve të tij.

Ejani, o besimtarë, sepse janë hapur dyert e parajsës.

O ju që keni bërë lëshime, ejani, sepse Zoti po ju ofron Mëshirën e Tij.

Mehmet Disha

Ramazani, muaji i ripërtëritjes shpirtërore



Në muajin e Ramazanit myslimanët përparojnë shpirtërisht në shkallë të ndryshme dhe sipas meritave fitojnë gëzime, qetësi dhe lehtësira të zemrës. Zemra, shpirti, mendja dhe sekretet e shqisave të besimtarëve në muajin e Ramazanit përsosen dhe fitojnë shumë ngazëllime shpirtërore.

Në ditët, orët dhe minutat e këtij muaji të bekuar, zemrat arrijnë kaq thellësi shpirtërore dhe bëhen aq të kthjellëta, saqë njerëzit kurrë nuk dëshirojnë të largohen nga atmosfera e kësaj paqeje. Pikërisht këtë nënkupton edhe fjala e Profetit Muhamed (a.s.) kur thotë: *"Sikur ta dinin njerëzit se ç'është muaji i Ramazanit, do të dëshironin që i gjithë viti të ishte Ramazan."*

Në muajin e Ramazanit njeriu furnizohet për të gjitha ditët e vitit, për këtë arsye Profeti (a.s.) para se të fillonte muaji i Ramazanit, i tubonte shokët dhe u fliste për vlerat e tij. Ky është një muaj i bekuar ku jetohej me emocione katër kushtet e Islamit. Në këtë muaj adhurimet shtohen dhe këndimi e leximi i Kur'anit duhet të dominojë më shumë se kurrë. Po të jetë se drita e Kur'anit dhe qytetërimi që sjell ai, të depërtonte në shpirtin e kësaj bote të ngulfatur nga problemet e shumta e të shumëllojshme, me siguri fati dhe ardhmëria e njerëzimit do të ndryshonte tërësisht, sepse parimet që sjell Islami janë në gjendje të përcaktojnë diagnozën e sëmundjeve dhe të krizave të sotme të botës dhe të gjejnë mjekimin e duhur.

Profeti Muhamed (a.s.) në lidhje me agjërimin dhe Kur'anin thotë: *"Edhe agjërimi, edhe Kur'ani, ditën e Kiametit do të ndërmjetësojnë për besimtarin. Agjërimi do të thotë: Zoti im! Unë agjëruem për pengova ditën nga të ngrënët, të pirët dhe nevojat e tjera të natyrshme; pranoma ndërmjetësimin për faljen e tij! Edhe Kur'ani kështu do të thotë: Zoti im! Unë kënduesin e pengova natën nga gjumi dhe pushimi; jepmë leje të ndërhyj për faljen e tij! Pas pranimit të këtyre lutjeve të agjërimit dhe Kur'anit, do të pranohet edhe ndërhyrja e tyre në favor të besimtarit."*

Njerëzit, nën perden e pakujdesisë të të mirave materiale, nuk arrijnë të vlerësojnë dhe të çmojnë të mirat e Allahut (xh.sh.). Nefsi i njeriut e harron vetveten, sepse mban dobësinë, varfërinë e pafundme dhe paaftësitë e panumërta. Ai nuk do që t'i shohë ato dhe ta kuptojë se është një i varfër që mund të shkojë drejt zhdukjes. Ai mendon se ka një trup prej çeliku, që kurrë nuk do

të zhduket, prandaj s'ulet pas interesave të kësaj bote, duke imagjinuar se nuk do të vdesë. Me një ambicie të tmerrshme shkon pas çdo gjëje që është e shijshme dhe e vlefshme, duke e harruar Krijuesin që e edukon me mëshirën e pasosur.

Agjërimi i Ramazanit u tregon dobësinë mosmirënjohësve, varfërinë dhe pakujdesinë e tyre. Për shkak të urisë ata mendojnë stomakun dhe e pranojnë nevojën e tij. Me anë të urisë së agjërimit, njeriu e kujton se sa mashtrues është trupi i tij dhe e pranon se ka nevojë për Mëshirën e Allahut (xh.sh.). Uria e shtyn të braktisë idhujtarinë e nefsit dhe të pranojë dobësinë dhe varfërinë e tij. Në këtë mënyrë i zgjohet dëshira që të mbështetet në praninë e Allahut (xh.sh.).

Nëpërmjet agjërimit njeriu aftësohet për të disiplinuar dëshirat e tij dhe ka vullnet e fuqi për të kryer çdo punë me përpikëri. Ai përsos aftësinë fizike dhe lartëson virtytet morale duke kultivuar të përshtaturit me kushtet e ndryshme social-ekonomike të jetës së përditshme. Duke agjëruar njeriu mënjanon me ndërgjegje ushqimin sipas orarit të caktuar në agim dhe në përfundim të diellit, largon mendimet dhe sjelljet e pahijshme dhe shton ndjenjën e tolerancës aq të nevojshme për shoqërinë ku jetojmë, duke kontribuar kështu për harmonizimin e raporteve në familje, punë dhe shoqëri. Përsosmëria më e madhe e tij është se ashtu siç na largon nga nevojat e stomakut, na pasturon edhe nga zilia e shqisave; syri, veshi, gjuha, zemra apo mendimet e liga të imagjinatës.

Bashkë me të gjithë besimtarët, fillimi i agjërimit në të njëjtin çast, pritja e iftarit, ngritja në syfyer, falja e teravive me xhemat, gdhirja e natës së kadrut, hyrja në bajram etj., bëhen shkak për një vëllazëri shumë të shëndoshë dhe për një dashuri të vërtetë. Kështu, besimtarët bëhen si gjymtyrët e një trupi të vetëm, ashtu siç shprehet edhe Profeti ynë: *"Në dashurinë për njëri-tjetrin, në dhimbjen për njëri-tjetrin dhe në dhembshurinë për njëri-tjetrin, besimtarët janë si një trup i vetëm. Po qe se një organ ankohet, organet e tjera rrinë pa gjumë e rënkajnë."* Me këtë mendim të lartë, në shoqëri ngrihen bashkimi dhe uniteti.

H. Bujar Spahiu



1

KRYETARI I KMSH-SËH. BUJAR SPAHIU MERR PJESË NË AKTIVITETIN, ME TITULL: "KONFERENCA E Mbledhjes së LIDERËVE PARLAMENTARË DHE FETARË"

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, udhëtoi për në Sarajevo të Bosnje-Hercegovinës, ku mori pjesë në aktivitetin, me titull: "Konferenca e Mbledhjes së Liderëve Parlamentarë dhe Fetarë" me ftesë të posaçme të Asamblesë së Parlamentit Boshnjak dhe Ligës së Botës Islame (RABITA), aktivitet ky i cili u zhvillua më 12 shkurt 2024.

Konferenca mbledhi së bashku kryetarë dhe anëtarë parlamentesh nga kontinenti evropian, udhëheqës fetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, akademikë dhe ekspertë të tjerë për t'u angazhuar në dialog dhe për të përcaktuar së bashku masat kyçe për të ndërtuar një shoqëri me të drejta dhe kohezive.

Gjatë kësaj vizite, Kryetari i KMSH-së shoqërohet nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli dhe drejtori i Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti. Kryetari Spahiu bashkë me shoqëruesit nga KMSH, gjatë qëndrimit atje, vizituan Atasheun Fetar të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnje dhe Hercegovinë, z. Amir al-Anezi. Kjo vizitë e delegacionit të KMSH-së në zyrën e Atasheut Fetar të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnje dhe Hercegovinë, vjen në kuadër të pjesëmarrjes së kryetarit Spahiu në aktivitetin me titull: "Konferenca e Mbledhjes së Liderëve Parlamentarë dhe Fetarë".

Gjatë qëndrimit disa ditore në Bosnje-Hercegovinë, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i shoqëruar nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli dhe drejtori i Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, vizituan Bashkësinë Fetare Islame të Bosnje-Hercegovinës, ku u pritën nga kryetari, z. Husein Kavazovic.

Gjatë kësaj vizite, të dy krerët e institucioneve, shprehën vlerësim të ndërsjellë karshi rolit konstruktiv të KMSH-së dhe Bashkësisë Fetare Islame të Bosnjes në mbarëvajtjen e shoqërive respektive.





2

VIZITA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË LIGËS SË BOTËS ISLAME, Z. MUHAMED BIN ABDULKERIM EL-ISA

Sekretari i Përgjithshëm i Ligës së Botës Islame, z. Muhamed bin Abdulkerim el-Isa, ishte në një vizitë disa ditore në vendin tonë. Në kuadër të kësaj vizite, ai vizitoi selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku u prit nga kryetari H. Bujar Spahiu dhe drejtues të tjerë të lartë të institucionit.

Gjatë këtyre ditëve, Ai vizitoi disa institucione të rëndësishme të KMSH, ku ndër to ishte edhe Kolegji Universitar "Bedër". KU "Bedër" e vlerësoi me titullin "Doctor Honoris Causa" Sekretarin e Përgjithshëm të Ligës së Botës Islame, z. Muhamed bin Abdulkerim el-Isa. Ai gjithashtu, gjatë qëndrimit në Shqipëri, i shoqëruar nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu dhe Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, vizituan Medresenë e Tiranës, ku u pritën nga Drejtori i saj, z. Ndrëçim Gjimi.

Vizita në këtë institucion arsimor ishte organizuar si një takim i të lartëpërmendurve me rreth 60 fëmijë jetimë të qytetit dhe fshatrave të Tiranës





3

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I LIGËS SË BOTËS ISLAME TAKIM ME KRERËT E KOMUNITETEVE FETARE TË VENDIT TONË

Sekretari i Përgjithshëm i Ligës së Botës Islame, z. Muhamed bin Abdulkerim el-Isa, zhvilloi takim me krerët e komuniteteve fetare të vendit tonë, takim ky i organizuar nën kujdesin e Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Në fjalën hapëse të këtij takimi, kryetari Spahiu vlerësoi bashkëpunimin dhe harmoninë që karakterizon marrëdhënien ndërmjet komuniteteve fetare të vendit tonë. Sipas tij, ky shembull është jetësuar tashmë në çdo qelizë të shoqërisë dhe si i tillë ruan dhe promovon bashkëjetesën në diversitet.

Menjëherë pas tij, fjalën e mori Dr. el-Isa, i cili u shpreh se kjo tryezë është tepër domethënëse dhe me plot mesazhe se Shqipëria është një model inspirues në bashkëjetesën ndërmjet besimeve fetare.

Më tej, krerët e komuniteteve fetare përshëndetën vizitën e Dr. el-Isa në vendin tonë si dhe vlerësuan kontributin e tij në fushën e dialogut, paqes, tolerancës dhe humanizmit në mbarë botën.





4

VIZITAT E AMBASADORËVE NË SELINË E KMSH

Gjatë muajit Shkurt, Ambasadori i Hollandës në vendin tonë, z. Reinout Vos, Ambasadori i ri i Gjermanisë, z. Karl Bergner, Ambasadori i Italisë, z. Fabrizio Bucci si dhe Këshilltari i Parë në Ambasadën e Francës në Shqipëri, z. Samuel Richard si dhe z. Renaud Dorlhac, Këshilltar Politik në po të njëjtin institucion, vizituan selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku janë pritur nga kryetari i institucionit, H. Bujar Spahiu.

Kryetari Spahiu, në çdo takim shprehu vlerësim ndaj angazhimit të tyre në forcimin e marrëdhënieve mes institucioneve tona. Më tej, ai u bëri me dije shkurtimisht në një përmbledhje të aktiviteteve kryesore të vitit jubilar të institucionit që sapo lam pas.

Ambasadorët, në çdo takim, vlerësuan lidshëpin e kryetarit Spahiu dhe rolin që ai luan për ruajtjen dhe forcimin e harmonisë ndërfetare në Shqipëri dhe kontributin për ta eksportuar këtë model bashkëjetese në Rajon e më gjerë.



AGJËRIMI NË HISTORI DHE RAMAZANI NË PRIZMIN ISLAM

Argumenti më i madh për ekzistencën e agjërimit edhe para Islamit është ajeti 183 i sures Bekare ku thuhet: **“O ju që besuat! Agjërimi ju është bërë obligim sikurse ishte obligim edhe për ata që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”**. Nga ky ajet Kuranor kuptojmë se agjërimi si adhurim, është shumë i hershëm dhe ka ekzistuar në të gjitha periudhat e historisë, pavarësisht nga forma, koha, synimi dhe përbërja. Agjërimi njihet tek popujt e hershëm, të cilët në shenjë respekti ndaj Zotit, agjëronin ditë të caktuara ose i ndalonin vetes disa ushqime. Ai është i njohur në të gjitha fetë e shpallura, madje dhe në paganizëm. Ka të dhëna se popuj të ndryshëm, si keltët, meksikanët e vjetër, peruanët dhe asorianët i kanë dhënë rëndësi agjërimit. Ai ishte i njohur dhe aplikohet edhe tek egjiptianët e lashtë, edhe tek grekët e vjetër. Këtë e praktikuan edhe babilonasit, kinezët e popuj të tjerë.

Edhe tek ithtarët e feve hyjnore “Ehlul Kitab” (Judaizmi dhe Krishtërimi), agjërimi njihet dhe praktikohet. Allahu e urdhëroi profetin Musa të agjëronte 30 ditë (të muajit Dhulkade) dhe pastaj edhe 10 ditë të tjera (të muajit Dhulhixhe), duke plotësuar kështu 40 ditë agjërimit. 30 ditët qenë ditë agjërimit, kurse 10 ditët e tjera, ditët e afërsisë dhe pëlqimit, si dhe në fund zbritja e Teuratit dhe biseda mes Zotit dhe profetit Musa. Ndërsa në burimet mbi agjërimit e krishterëve hasim në veçorinë se para

profetësisë, Hz. Isai mbante 40 ditë agjërimit. Profeti Isa nuk ka vënë konkluzione të veçanta mbi agjërimitin.

Islami si fe e drejtë dhe e vërtetë, i ka urdhëruar përfaqësuesit e vet të kryejnë disa adhurime duke vënë si kusht të qenit mysliman. Si datë, agjërimi në Ramazan është bërë obligim në vitin e dytë të hixhretit, një muaj pasi kibla u kthye kah Qabja. Në kuptimin terminologjik të Islamit, fjala agjërimit do të thotë ndërprerje e ngrënies, pirjes dhe marrëdhënieve intime nga agimi deri në përfundim të diellit me një synim të caktuar dhe në mënyrë të vetëdijshme.

Në pjesën e dytë të ajetit, Allahu na bën të qartë synimin e agjërimit, i cili është devotshmëria. Kjo devotshmëri ka të bëjë me drejtimin vertikal dhe horizontal, pra si në marrëdhënie me Zotin, ashtu edhe në marrëdhënie me njerëzit. Muaji i Ramazanit është muaji i shpërblimit, muaji i bujarisë, muaji i dashurisë vëllazërore, muaji i durimit etj. Këto nuk janë formula apo klishe që sa herë të vijë Ramazani i themi, por mbështeten fort mbi baza të forta. P.sh.:

Muaji i shpërblimit: Në një hadith Kudsij Allahu thotë: “Çdo punë e njeriut është e tija, përveç agjërimit. Ai është i Imi dhe vetëm Unë e jap shpërblimin për të. Besimtari lë ushqimin për Mua, largohet nga gruaja e tij vetëm për Mua dhe braktis dëshirat e tij vetëm për Mua.” Thotë Profeti Muhamed (a.s.): *“Ai që bën një të mirë gjatë këtij*

muaji është sikur të ketë kryer një farz (detyrim) në muajt e tjerë. Dhe ai që zbaton një farz këtë muaj, është sikur të kishte kryer shtatëdhjetë farze gjatë muajve të tjerë.”

Muaji i bujarisë: Muaji i Ramazanit, është edhe koha kur zgjojmë dhembshurinë, mëshirën dhe solidaritetin me të tjerët, sidomos me të varfrit, të cilëve duhet t’u gjendemi më afër se kurrë, duke iu përgjigjur nevojave të tyre; sepse në këtë muaj ne vetë e përjetojmë urinë, të cilin i vobekti e përjeton në çdo kohë. Muaji i Ramazanit njihet si muaji i përkujdesjes. *“Kush i jep iftar një të agjëruari, është falje për mëkatet e tij dhe shpëtimin nga xhehenemit dhe, me këtë, përfiton shpërblimin e një agjërimi, pa iu pakësuar shpërblimi aspak ngrënësit të iftarit. Atëherë shokët e tij i thanë: O i dërguari i Allahut! Të gjithë ne nuk mund të gjejmë mundësi për t’i dhënë iftar një të agjëruari! Në fjalë e sipër Profeti (a.s.) tha: Këtë të mirë Allahu ia jep dhënësit të iftarit edhe me një hurmë, me ujë të pijshëm apo me një glënjikë qumësht.”*

Muaji i dashurisë vëllazërore: *“Ramazani është muaji i barazisë në vuajtjet, dhimbjet dhe hidhërimet e të tjerëve.”* Kështu, besimtarët bëhen si gjymtyrët e një trupi të vetëm, ashtu siç shprehet edhe Profeti ynë: *“Në dashurinë për njëri-tjetrin, në dhimbjen për njëri-tjetrin dhe në dhembshurinë për njëri-tjetrin, besimtarët janë si një trup i vetëm. Po qe se një organ ankohet, organet e tjera rrinë pa gjumë e rënkojnë.”* Me këtë mendim të lartë,

në shoqëri ngrihen bashkimi dhe uniteti.

Muaji i durimit: Durim përballë shumë shqetësimeve, ngacmimeve shjetanike apo njerëzve gërricës. *“Ramazani është muaji i durimit, kurse shpërblimi i durimit është xheneti.”* Myslimanët mbajnë parasysh këshillat e të dërguarit të Allahut: *“Po qe se, ndërsa jeni të agjëruar, dikush ju ofendon ose ju godet, thojini: Unë jam me agjërim.”* Kështu, me të gjithë, në familje, në punë, në shoqëri etj.

Në këtë muaj gjuha jonë duhet të laget me përmendjen e Allahut kudo që të jemi, në punë zyrtare apo tregtare dhe lutjet tona duhet të jenë të pareshtura. *“Në këtë muaj zbatoni së tepërmi katër gjëra të rëndësishme. Dy prej tyre janë për të fituar kënaqësinë e Allahut, ndërsa dy të tjerat janë gjëra që asnjëherë nuk mund të qëndroni larg tyre. Gjërat që shërbejnë për fitimin e kënaqësisë së Allahut janë thënia e shpeshtë e kelime-i teuhidit dhe e kërkimit falje, kurse dy gjërat që s’mund të qëndroni larg tyre janë kërkimi i vazhdueshëm i xhenetit nga Allahu dhe kërkimi i mbrojtjes së Tij nga zjarri i xhehenemit.”*

Muaji i Ramazanit është si një dush shpirtëror që njeriu hyn një herë në vit, për të dalë më pas prej tij i pastër nga gjynahet. Këtë nënkupton edhe hadithi: *“Kush agjëron muajin e Ramazanit me besim të plotë dhe shpresë tek Allahu, i falen të gjitha mëkatet e tij.”*

Dorian Demetja

Pasimi i shkaqeve dhe Dhulkarnejni

Në Kur'an, shumë koncepte i afrohen të kuptuarit tonë përmes tregimeve. Shumica e këtyre tregimeve kanë të bëjnë me pejgamberet. Koncepti temekkun është një koncept i përmendur në tregimet e Jusufit (a.s) dhe Dhulkarnejnit dhe përdoret në kuptimin e vendosjes në një vend, të pasurit dinjitet dhe kujdes, të kesh gradë pranë sulltanit, të bëhesh shkollë dhe të lësh rrënjë.¹

Konceptin *temekkun*, i cili përmendet në dy vende në suren Jusuf, u përpoqem ta shpjegojmë në dy artikujt tanë të mëparshëm.² Në shkrimet e mëparshme e kemi përmbledhur temekkunin si: ballafaqim me padrejtësitë, ruajtja e asaj që u ishte dhënë nga Zoti dhe leximi i mirë i kohës dhe hapësirës. Ndërkaq në këtë artikull do të fokusohemi në respektimin e shkaqeve, që është një tjetër dimension i konceptit të *temekkunit*.

Tregimi i fundit i sures El-Kehf është tregimi i Dhulkarnejnit, i cili fillon me ajetin e 83-të dhe vazhdon deri në ajetin e 99-të. *Temekkun* përmendet në ajetet 84 dhe 85: *"Ne i mundësuam atij forcë [mekkenne] në tokë dhe i dhamë mundësi për çdo send që të mund të arrijë. Ai iu rrek një aso mundësie (dhe mori rrugën)." (El-Kehf, 18/84-85).*

Këtu fjala temekkun lidhet me togfjalëshin "Etbea sebebe" me lidhëzën "fe". "Fe etbea sebebe", "Kështu (Dhulkarnejni) ndoqi një arsye, pra do të thotë u nis duke ndjekur një rrugë". Lidhja e përdorur ndërmjet këtyre dy ajeteve është lidhëza "përcjellëse fe" dhe nënkupton një vazhdim më të shpejtë se lidhëza "ve/dhe" në arabisht, d.m.th., Allahu shkaktoi/shfaqi disa shkaqe dhe Dhulkarnejni duke i lexuar/kuptuar drejt i ndoqi menjëherë.

Dhulkarnejni ishte një burrë shteti i madh, i cili udhëtoi në lindje dhe perëndim dhe ndërtoi argjinatura prej hekuri të përzier me bakër. Në të dhënat historike ka rrëfime se ai ka jetuar në periudha të ndryshme, por ne shikojmë variacionet e këtyre fakteve, jo vërtetësinë, dhe synojmë të nxjerrim një mësim prej tyre. Ashtu sikurse për Khidrin, edhe për Dhulkarnejnin, ka pasur diskutime nëse ka qenë pejgamberë apo një nga njerëzit me pozitë të lartë tek Allahu. Sipas fjalëve të përdorura në Kur'an, dijetarët janë fokusuar më shumë në mundësinë që Dhulkarnejni dhe Khidri të kenë marrë shpallje.

Ajo që është e sigurt për Dhulkarnejnin, qoftë ai pejgamberë apo jo, është se ai ishte së paku, siç ka thënë Aliu (r.a), një rob që e donte Zotin dhe ishte i

dashur nga Zoti dhe që ishte një burrështetas që kishte ndikim në raportet mes shteteve të kohës së tij dhe që vepronte me drejtësi.

Dhulkarnejni është një person që shkoi në qytetet ku kishte trazira dhe siguronte paqen, i cili parandaloi problemet e ardhshme duke ndërtuar argjinatura. Ishte një burrë që me largpamësinë dhe mprehtësinë që i kishte dhuruar Allahu i ndjente prapaskenat e mundësive dhe i përdori ato në kohën dhe vendin me të drejtë; ishte një person që fjala i ecte për kohën dhe vendin ku gjendej. Ashtu siç mund t'i quajmë të gjithë pejgamberet dhe trashëgimtarët e tyre si njerëz "të zgjidhjeve dhe paqes", gjithashtu edhe Dhulkarnejnin mund ta quajmë të tillë.

Surja në të cilën koncepti temekkun shpjegohet në kontekstin e historisë së Dhulkarnejnit është sureja el-El-Kehf. Në këtë sure ne shohim periudhën e shpellës së shokëve të shpellës (Ashabu'l-Kehf), sprovën e kësaj bote të përshkruar në tregimin e pronarëve të kopshtit, historinë e Hazreti Khidrit, i cila bashkon materien dhe kuptimin, dhe misionin e Dhulkarnejnit, i cili përfundon me rolin dhe ndikimin e tij. Në fakt, rendi në jetën e trashëgimtarëve të tokës është pikërisht i tillë. Pas një periudhe rimbushjeje dhe tensioni në shpellë si shokët e shpellës, duke iu nënshtruar sprovave dhe largimi nga materia, pastaj takimi dhe balancimi i së jashtmes dhe së brendshmes dhe në fund vendosja e suksesit dhe drejtësisë që arrihet duke lexuar shkaqet siç duhet. Të gjithë personazhet e përshkruar në këtë sure kanë të njëjtin tipar të përbashkët, dmth nëse e merr Dhulkarnejnin dhe e fut në shpellë, nëse e merr Jemlihan nga shpella dhe e zëvendëson me Dhulkarnejnin, nëse e merr Mekselinën³ dhe vendoseni në vendin e fatlumit nga pronarët e kopshtit, nuk do të ketë asnjë ndryshim të këtyre personazheve. E përbashkëta e secilit prej këtyre karaktereve është se ata e lexojnë mirë kohën dhe mjedisin dhe i ndjekin me përpikëri shkaqet, pa e lënë as edhe një çast mbështetjen tek Allahu.

"Sebeb/Shkak" përdoret për të nënkuptuar diçka që shkakton diçka të ndodhë ose të jetë në një mënyrë të caktuar. Ndjekja e shkaqeve është një çështje e rëndësishme, qoftë në jetën tonë personale apo shoqërore. Në shumicën e rasteve, ne vendosim qëllime të vogla ose të mëdha dhe ndjekim shkaqet duke arritur këto qëllime. Ky vazhdim është gjithashtu udhërrëfyese ynë. Sa më e dukshme të jetë kjo hartë, aq më e lehtë do të jetë ta ndiqni atë. Disiplina dhe vendosmëria jonë e nxjerrin shtegun në këtë hartë me vija të trasha, kështu që rruga në hartë duket e lehtë.

Sukseset në të gjitha anët e jetës, varen duke ecur drejt qëllimeve të përcaktuara me përdorimin e provave

3. Këta janë emrat e Shokëve të shpellës (Ashabu'l-Kehf). Ndër emrat e tjerë mendohet se janë Misliha, Mernush, Debernush, Shazenuh, Kefeshatatajush dhe qeni që gjendej me ta Kitmir (Shënim i përkthyesit).

1. Përveç këtyre kuptimeve kjo fjalë barte edhe kuptime të tjera si njohje, aftësi, mundësi, zotësi, kompetencë, kapacitet, fuqi, forcë, potencë; pushtet. Prandaj ne do ta lëmë këtë fjalë në origjinal po i dhënë përkthim të veçantë (Shënim i përkthyesit).

2. Mehmet Ateş, "Hicret Diyarlarında Kök Salmak", Çağlayan, Kasım 2022; "Önce Muhafaza Sonra Bilme", Çağlayan, Ocak 2023.

të dëshmuara. Një çështje tjetër e rëndësishme këtu është përcaktimi i prioriteteve. Një aspekt i rëndësishëm që u jep njerëzve përvojë është ndjekja e saktë e sebepeve. Përvoja është një nga konceptet më të vështira dhe më të shtrenjta në jetë. Gjetja e zgjidhjeve të problemeve duke iu përmbajtur zakoneve (adetu-llah) dhe ligjeve (sunnetu-llah) të Allahut dhe pa anashkaluar shkaqet është një nga gjërat që kemi më shumë nevojë në kohën tonë.

Ekziston një thënie që Bediuzamani ka thënë rreth 100 vjet më parë: "O ju që keni përgjegjësi! Nëse dëshironi sukses, ndiqni me sukses rregullat e Zotit, veproni sipas parimeve zakonore të Allahut. Përndryshe, do të dështoni duke marr një përgjigje mossuksesit."⁴

Përputhshmërinë me shkaqet mund ta kuptojmë edhe si veprim në përputhje me zakonet e ligjet e Allahut. Adatullah dhe sunnetullah janë ligjet e Allahut që veprojnë në univers. Sa më saktë t'i lexojmë këto ligje, aq më të suksesshëm do të jemi dhe aq më shumë mund të hedhim rrënjë dhe të bëhemi shkollë në vendet ku ndodhemi, siç shpjegohet në ajetin e mësipërm. Përndryshe, nuk do të jetë e lehtë të vendosim rrënjë në qytetet ku sapo kemi ardhur. Të lexojmë mirë se çfarë na pëshpërit koha dhe vendi ku ndodhemi, të përcaktojmë rrjedhën e veprimit dhe të prodhojmë zgjidhje në përputhje me rrethanat, do të jetë një nga kërkesat e shkollimit tonë, domethënë temekkuni ynë.

Duke i lexuar me kujdes këto ligje, ne mund të drejtojmë më saktë jetën shoqërore dhe jetën tonë. Për këtë qëllim, vështrimi ynë nuk duhet të ndalet tek "perceptimi", por të arrijë largpamësinë, të ndalet aty pak dhe të arrijë mprehtësinë dhe në fund të arrijë largpamësinë në rrëzë të mprehtësisë. Sepse perceptimi është shikimi i syve, mprehtësia është shikimi i zemrës dhe largpamësia është shikimi dhe dëgjimi me ndërjegje. Lëvizja e perspektivës së dikujt nga "perceptimi" në mprehtësi kërkon vlerësimin e ngjarjeve nga një perspektivë holistike/e përgjithshme.

Ligjet e krijimit në univers funksionojnë njësoj për çdo person, domethënë nuk ka rëndësi nëse ai është besimtar apo jobesimtar. Mund të ketë bekime shitesë të përjetuara [për besimtarët]; por këto nuk nënkuptojnë ndryshimin e ligjeve të krijimit. Këto ligje nuk ndryshojnë, në fakt Kur'ani gjithashtu thekson se këto zakone nuk do të ndryshojnë: *"Ky është ligji i Allahut që ka qenë i vlefshëm që nga kohra të lashta. Dhe ju nuk do të gjeni ndonjë ndryshim në urdhrin e Allahut."*(Feth, 48/23).

4. Bediüzzaman Said Nursi, Tarihçe-i Hayat. İstanbul: Şahdamar Yayınları, 2010, fq. 53.

Kuptimi i saktë i shprehjes "herët a vonë" që përdorim janë në fakt shkaqet që duhen ndjekur. Allahu premton se njeriu do të shpërblehet për punën e tij herët a vonë, gjegjësisht përpjekjet e robit të tij nuk do të mbeten kurrë pa shpërblim. Këtë e kërkojnë edhe parimet e ligjeve të Allahut. Nëse një individ punon me mendjen apo trupin e tij, ai do të marrë një shpërblim në përpjesëtim me përpjekjen që bën: *"Dhe se njeriut nuk i takon tjetër pos asaj që ka punuar. Dhe se mundi i tij më vonë do të shihet. Pastaj ai shpërblehet ose dënohet më plotësisht."*(En-Nexhm, 53/39-41).

Gjëja e rëndësishme është të jesh në gjendje ta shfaqësh këtë mund dhe përpjekje me mprehtësi në përputhje me ligjet e Allahut, d.m.th., ecja me erën prapa e jo kundër erës do të rrisë suksesin. Kjo kërkon të analizohet mirë koha dhe hapësira dhe të veprohet me kujdes në përputhje me rrethanat. Nuk ka temekkun (aftësi/pushtet) pa temkin (veprim me kriter). Kur shikohet ajeti, nuk duhet harruar se temekkuni është një bekim i përmendur nga Allahu. Ai është një mjet për t'u përputhur me shkaqet. Pajtueshmëria me shkaqet është gjithashtu një kërkesë e vlefshme për lehtësim.

Duke iu përmbajtur sebepeve, Dhulkarnejni ishte në gjendje të bëhej i dëgjuar dhe të bëhej pengesë kundër padrejtësisë. Nëse kjo rrugë e shenjtë mund të ndiqet në vijën e normave të Allahut, qëllimi do të arrihet me mëshirën e Allahut. Të jesh Dhulkarnejn do të thotë të jesh Jemliha, Mekselina dhe Mislina në shpellë. Ata që, si këta të rinj, ruajnë frymën e sakrificës, takohen me Khidrin dhe bashkojnë materien dhe kuptimin pa u ngecur në kopshtet e botës, mund të ngrënë një barrierë kundër padrejtësisë dhe të bëhen shkollë në kohën dhe vendin e tyre.

Viktimat dhe njerëzit e sotëm të shtypur, në dritën e Kur'anit, pa lënë drejtësinë për asnjë çast, pasi të kenë përfunduar periudhën e shpellës dhe të kenë kaluar sprovat e botës, do të marrin mësim urtësie nga frymërat e Khidrit dhe do të arrijnë urtësinë dhe me lejen e Allahut, ata përfundimisht do t'i bashkohen misionit të Hazreti Dhulkarnejnit dhe do të kryejnë detyra të ngjashme. E rëndësishme është të jesh në gjendje të ndjesh të gjitha periudhat deri në palcë duke ecur në këtë rrugë të bukur jetësore që do të përfundojë me "kuvet"⁵ duke kaluar një nga një këto faza.

Përktheu: Haki Sahitaj

5. Në original 'mükne' që do të thotë të zotërosh mundësi, fuqi dhe pushtet.



Gruaja u nderua me *Islamin*

Feja Islame është një fe universale, e cila e ka marrë iniciativën e fjalës rreth të drejtave të gruas. Po t'i hedhim një vështrim Kuranit, këshillave të Profetit të nderuar apo rrjedhës së gjatë të historisë, shihet qartë që gruaja ka arritur pozicionin më të lartë dhe më të nderuar me fenë Islame.

Pozicionin që i ka dhënë Islami gruas, nuk e shikojmë në sistemet e tjera, madje as në shoqëritë më moderne të ditëve të sotme. Edhe nëse gruaja zotëron një liri të caktuar në shoqëritë e ditëve të sotme, kjo liri është një lloj lirie e të shijuarit të kënaqësive materiale. Një liri e tillë nuk është një liri e pranueshme për natyrën e vërtetë njerëzore, as për një mendje të shëndoshë, si dhe nuk mund të pranohet nga asnjë fe hyjnore. Jeta e vështirë e krijuar kohët e fundit dhe trysnia e kërkesave ekonomike e detyruan femrën të aktivizohet në jetën sociale. Pas këtij aktivizimi, femra filloi të fitojë të ardhurat e saj dhe të përfitojë një liri ekonomike në planin individual. Por nuk duhet të harrojmë që, në shumë vende ajo nuk ka mundur të shpëtojë nga shndërrimi në një subjekt abuzimi për shumë financues, të cilët kërkojnë të shfrytëzojnë bukurinë e saj fizike. Fatkeqësisht femra në shoqëritë perëndimore ka kontribuar në rritjen e vlerës së konsumit të nxjerrë në shitje,

rritjen e tregut dhe u ka shërbyer dëshirave të meshkujve. Për këtë arsye, në një moment të jetës së saj ka arritur të gjejë vetëm një dashuri artificiale, por ka humbur vlerën, respektin dhe dashurinë e vyer, vendin e së cilës nuk mund ta zërë askush përveç një nëne, bashkëshorteje apo gjysheje. Me kalimin e kohës këtë herë këllëfi i lirisë është mveshur dhe shtypur me teknika moderne. Shumicës së njerëzve u janë cenuar të drejtat dhe janë bërë viktimë e abuzimeve të ngjashme me ato të shekujve të errët.

Interpretimi i gabuar, ku imazhit të gruas së Ademit (Havasw ose Evws) i është ngarkuar përgjegjësia e mëkatit të parë, është bërë shkak për lindjen e analizave shumë negative rreth gruas për shekuj me radhë. Por Islami e sheh gruan ashtu siç sheh dhe burrin. Ashtu siç e shohim dhe në Kur'an, në fillim është krijuar Ademi, më pas nga ai u krijua Havaja. Përshkrimi kuranor qëndron në paraqitjen e barabartë të burrit dhe gruas pa bërë asnjë dallim dhe është për t'u theksuar fakti që këto të dy janë krijuar për të plotësuar njëri-tjetrin. Megjithatë mes burrit dhe gruas mund të ekzistojnë disa ndryshime që mund të konsiderohen si rezultat i një dizajni të veçantë, të programuar për shumë çështje të rëndësishme, në mes tyre



nuk mund të bëhet fjalë për një ndryshim ontologjik.

Dy trupa, një shpirt

Zoti nuk e ka krijuar gruan ndryshe, por bashkëshorte të burrit, e me këto cilësi ata nuk mund të bëjë pa njëri-tjetrin. Me gjithw bukuritw magjepswe tw Xhenetit, Ademi ndihej vetëm dhe i trishtuar për sa kohë endej i vetëm në parajsë. Edhe sikur të krijohet Havaja e para do të përjetonte të njëjtwn mwrzi, sepse që nga krijimi, Ademi nuk mund të ekzistonte pa Havanë dhe Havaja nuk mund të ekzistonte pa Ademin. Ata ishin si dy trupa dhe një shpirt, duke pasqyruar dy fytyrat e ndryshme të të njëjtit realitet.

Ashtu siç pozitivja ka nevojë për negativën, elektroni për protonin, vera për dimrin, toka për qiellin; po ashtu dhe gruaja ka nevojë për burrin dhe burri për gruan. Profeti Muhamed (a.s.) e ka shprehur shumë bukur: "Gruaja wshtw gjysma e burrit". Bazuar në këtë përcaktim, burri dhe gruaja janë dy gjysma të barabarta, por asnjëherë njëra pjesë nuk mund të jetë e njëjtë me tjetrën. Në secilin prej tyre ekzistojnë disa dallime fizike, psikologjike dhe të botës shpirtërore, por as burri nuk është një formë më e pjekur e gruas dhe, as gruaja nuk është një pjesë e mangët dhe e pazhvilluar e burrit. Të dy janë individë të veçantë qw kanë nevojë për njëri-tjetrin.

Bazuar në këtë botëkuptim, femra është lartësuar në postin më të ndritur, asaj i janë ngarkuar punë të përshtatshme me natyrshmërinë e saj dhe është ripërcaktuar pozicioni i saj jetik brenda shoqërisë. Ky revolucion është zhvilluar pikërisht atëherë kur bota ishte zhytur në një barbarizëm, ku diskutohet nëse gruaja ishte apo jo njeri, në një epokë të errët në të cilën flitej nëse gruaja kishte apo jo shpirt. Bashkë me këtë, gratë nuk ishin ngarkuar me shumë përgjegjësi siç ishte ngarkuar burri. Heqja e disa përgjegjësive nuk është bërë me qëllimin e paraqitjes së tyre si krijesa apo genie të mangëta. Përkundrazi, shpëtimi nga disa përgjegjësi të burrit është rezultat i mëshirës hyjnore dhe në një njwfarw mënyre, pozicionimi i gruas nw Islam është manifestim i kwsaj mëshire. Ky pasqyrim mëshire shprehet qartë këtu: gruaja është më e mëshirshme dhe më e dhimbshme se burri. Dhe si një kompliment për dhembshurinë e saj të pafund, Mëshiruesi i mëshiruesve ia ka dhuruar dhe përshtatur këtë cilësi gruas, duke hequr prej saj disa përgjegjësi dhe, siç thotw Profeti Muhamed (a.s.) për figurën e nënës: 'Xheneti është te këmbët e saj'.

Fatma Karaj

Jurisprudenca e **Agjërimit**



Kush duhet të agjërojë

Ashtu si te adhurimet e tjera, edhe te agjërimi, janë bërë përgjegjës për të agjëruar personat që kanë zotëruar kriterat e kërkuara tek ta. Këto mund t'i radhisim:

1) Personi duhet të jetë mysliman. Që dikush ta ketë detyrim (farz) agjërimin, duhet ta ketë pranuar Islamin, domethënë duhet të jetë mysliman. Personat që nuk janë myslimanë nuk mund të detyrohen të agjërojnë.

2) Personi duhet të ketë mbushur moshën e pubertetit dhe të ketë zhvillim mendor normal. Që dikush të jetë i detyruar për të kryer adhurimet që përmban Islami, duhet të plotësojë edhe këto dy kushte si më sipër: Të ketë arritur moshën e pubertetit dhe në të njëjtën kohë, të ketë zhvillim mendor normal. Në Islam, personat që nuk e kanë mbushur ende moshën e pubertetit, nuk konsiderohen fetarisht përgjegjës për të kryer adhurime të caktuara. Konkretisht, fëmijët dhe personat me të meta mendore janë përjashtuar nga detyrimi i agjërimit. Këtë specifikë i dërguari i Allahut (s.a.s.) e ka bërë të ditur me këto fjalë: "Përgjegjësia është hequr nga tre vetë: Nga fëmija që s'ka arritur ende moshën e pjekurisë seksuale (adoleshencës), nga i sëmuri mendor gjersa të shërohet dhe nga personi që fle gjersa të zgjohet!" (Buhari, Hudud, 22; Ebu Davud, Hudud, 17; Tirmidhi, Hudud, 1; Ibni Maxhe, Talak, 15; Ahmed b. Hanbel, Musned, 6/100, 101, 144).

3) Personi duhet të jetë i shëndetshëm për të agjëruar dhe duhet të jetë vendas. Që dikush ta ketë për detyrë (farz) agjërimin, duhet të jetë fizikisht i shëndoshë (të mos ketë të meta trupore që e bëjnë të paaftë për të agjëruar), duhet të jetë klinikisht i shëndoshë, pra të mos jetë i sëmurë dhe të jetë vendas, pra jo në udhëtim. Ndërkaq, po qe se këta persona, megjithëkëtë agjërojnë, agjërimi i tyre është i vlefshëm. Por po qe se e përdorin lejen që u është dhënë dhe nuk agjërojnë, ditët e paagjëruara i zëvendësojnë në një kohë më pas.

Kush nuk agjëron

1. Udhëtari. Në një situatë të tillë, për shkak të vështirësive të udhëtimit, njeriu mund ta ketë të vështirë për të mbajtur agjërim. Për këtë arsye Kur'ani, myslimanët në gjendje udhëtimi i ka lejuar të mos agjërojnë. Ai që nuk ka mundur të agjërojë duke qenë në udhëtim, ditët e paagjëruara i agjëron si kaza më pas. Por ata që dëshirojnë, mund të agjërojnë edhe kur ndodhen në udhëtim.

2. Sëmundja. Krijuesi i Lartë u ka dhënë leje edhe personave të sëmurë që nuk mund të agjërojnë, i ka përjashtuar ata nga përgjegjësia e agjërimit. Këta, pasi të shërohen, agjërimet e pambajtura i mbajnë kaza. Kurse të sëmurët me sëmundje të rënda, me ecuri të gjatë ose të pashërueshme, të cilët nuk mund të agjërojnë, duhet të japin shpërblim (fidje). Kur'ani urdhëron e thotë:

"Agjërimi përbëhet prej ditësh të caktuara (të numëruara). Kush nga ju është i sëmurë ose udhëtar gjatë atyre ditëve, ditët e paagjëruara i agjëron më pas. Ata që nuk agjërojnë dot, duhet të paguajnë shpërblim (fidje). Fidja është masa (monetare ose ushqimore) sa për të ushqyer një të varfër. Kush e rrit masën e fidjes për të bërë mirësi, sigurisht e ka për dobi të vet. Megjithëkëtë, po ta dini të vërtetën, mbajta

e agjërimit është më e mbarë për ju!" (Bekare, 184)

3. Pleqëria. Islami u ka dhënë leje për të mos agjëruar personave me pleqëri të rënduar, që nuk mund të agjërojnë me kusht që për çdo ditë të paagjëruar të ushqejnë një të varfër.

4. Gratë me arsye. Gratë me të përmuajshmet, lehona, shtatzëna ose në periudhën e laktacionit (me fëmijë në gji), me qëllim që të mos dëmtohen vetë si dhe fëmijët e tyre, përfitojnë nga leja për të mos agjëruar. Ato i agjërojnë më vonë kaza ditët e paagjëruara (Ibni Maxhe, Sijam, 3; Nesai, Sijam, 50-51, 62).

5. Uria dhe etja e thellë. Po qe se personi që agjëron përballet me një etje ose uri të rëndë dhe po qe se frikësohet se mos agjërimi do t'ia prekë në përmasa serioze shëndetin trupor dhe psikik, ose po qe se mjeku i jep raport për të mos agjëruar, ky person përjashtohet nga detyrimi i agjërimit në këto kushte dhe, pasi të fitojë shëndet të plotë, e plotëson këtë adhurim duke i zëvendësuar ditët e paagjëruara.

Çfarë e prish agjërimin

Në këndvështrim të përgjithshëm agjërimin e prishin:

- Marrëdhëniet seksuale mes burrit dhe gruas nga agimi deri në perëndimin e diellit.

- Ngënia, pirja apo përdorimi i ilaçeve

- Pirja e duhanit, thithja e thellë e tymrave, avujve etj.

- Përtypja e çamçakëzimit

- Hyrja në trup e diçkaje nga goja, hunda, veshi etj.

- Dalja e gjakut nga goja dhe gëlltitja e tij, etj.

Abdullahu, djali i Abazit, ka treguar se profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: "Prishja e agjërimit vjen nga ato sende që hyjnë në trup e jo nga ato që dalin prej tij" (Buhari, Tirmidhi).

Si për çdo adhurim, edhe për agjërimin e muajit të Ramazanit që mbahet një herë në vit, ka një sërë rregullash që duhen respektuar. Këto rregulla kanë të bëjnë me tri lloje situatash në të cilat gjendet personi që agjëron:

1) Situatat që e prishin agjërimin, por kërkojnë vetëm (kazanë), zëvendësimin e tij. Këto situata ndodhin kur agjëruesi padashje me shkujdesjen e tij, ose duke gabuar pa qëllim, e prish agjërimin. Në këto lloj rastesh, personi vetëm atë ditë e kompenson pas muajit të Ramazanit.

2) Situatat që e prishin agjërimin dhe kërkojnë edhe kazanë, edhe (kefare) kundërshpërblimin e tij. Kjo ndodh kur agjëruesi e prish agjërimin pa arsyet e caktuara, me qëllim dhe vetëdije të plotë. Ai që e prish me dashje agjërimin e Ramazanit, duhet të agjërojë ditën ose ditët që ka prishur, si dhe gjashtëdhjetë ditë radhazi pa ndërprerje si ndëshkim. Në pamundësi për këtë duhet të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër.

3) Situatat që nuk e prishin agjërimin kur ndodhin në harresë. Kur agjëruesi në harresë e sipër e prish agjërimin, prej tij nuk kërkohet gjë tjetër veç të vazhdojë agjërimin. Një herë erdhi një sahabë te Profeti (a.s.) dhe i tha: O i dërguari i Zotit! Kam harruar se jam me agjërim dhe kam ngrënë e kam pirë. Profeti (a.s.) i tha: "Vazhdo në agjërimin tënd, Zoti (xh.sh.) ta ka dhuruar atë ngrënie e pirje" (Buhari).

Redaksia

Profeti Muhamed (a.s.) dhe të rinjtë: Kuptimi i Jetës

Profeti Muhamed a.s i ka kushtuar një rëndësi të madhe të rinjve dhe moshës së rinisë duke i udhërrëfyer për të shfrytëzuar në mënyrën më të drejtë dhe të dobishme këtë periudhë të jetës. Emocioni, fuqia, dinamika dhe idealizmi që i ka karakterizuar të rinjtë ka pasur një rol të rëndësishëm në përhapjen e fesë, themelimin e një qytetërimi dhe zhvillimin e shoqërisë myslimane. Për të arritur këtë, ai frymëzoi në zemrat e tyre besimin te Zoti, për jetët e tyre kuptim, për ëndrrat e tyre qëllim, për shpirtrat e tyre horizont, për vullnetin e tyre vetëdije, për mendjet e tyre dituri dhe shkencë dhe dashurinë për të ripërtëritur e zhvilluar vetveten në mënyre të vazhdueshme. Ai i edukoi ata sipas karakterit dhe potencialeve si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik dhe i orientoi në fushat dhe detyrat ku mund të ishin më të dobishëm, produktiv e në përputhje me natyrën e tyre. Kështu ata e shfrytëzuan këtë periudhë dinamike të jetës në shërbim të vërtetës, mirësisë, urtësisë, shërbimit ndaj shoqërisë dhe nënshtrimit ndaj Zotit.

Aftësia e Profetit Muhamed a.s për të fituar zemrat e të rinjve, lidhja e fortë dhe e qëndrueshme që krijoi me ta, suksesi i lartë në edukimin dhe zhvillimin e tyre, fitoret dhe përçimi i kauzës që arriti me anë të guximit, përpjekjes, bujarisë dhe trimërisë së tyre nuk ishin aspak rastësi. Të rinjtë ishin ndikuar thellësisht nga cilësitë e Profetit Muhamed a.s si: karakteri i tij i qëndrueshëm, personaliteti shembullor, besimi i patundur, lidhja e thellë dhe e qëndrueshme me Zotin, vullneti i pathyeshëm, shpresa e pafundme, vendosmëria dhe fuqia që rritej në mënyrë të vazhdueshme, morali, qëllimet e larta, thjeshtësia, lidhjet njerëzore të krijuara nëpërmjet besnikërisë dhe sinqeritetit, të kuptuarit e ekzistencës dhe njeriut, botëkuptimi mbi jetën, mënyra e zgjidhjes së problemeve, gjendja dhe veprimet plot urtësi, filozofia e edukimit, metodologjia dhe parimet, dhembshuria, toleranca dhe besimi kundrejt tyre.

Përtej këtyre çështjeve, angazhimi i Profetit Muhamed a.s për tu dalë për zot të rinjve, interesimi nga afër për problemet e tyre, ndjekja në mënyrë të qëndrueshme dhe gjetja e zgjidhjeve, i frymëzonte të rinjtë të mblidheshin me zell rreth Profetit a.s e të lidheshin më shumë me të, të bënin çdo sakrificë për kauzën e tij dhe të ndërtonin jetën sipas shembullit të tij. Si një Profet dhe udhëheqës që mbante mbi supe përgjegjësitë e çdo njeriu, ndjente në zemër për vuajtjen e çdo besimtari, me ndjeshmërinë e një prindi dridhej sipër tyre dhe hapte pafundësisht krahët e tij të dashurisë, dhembshurisë, mëshirës dhe modestisë, interesohej një për një për problemet

e të rinjve duke u marrë personalisht me to, duke i dëgjuar, lehtësuar dhimbjet që shpirtrat e tyre të gjenin paqe dhe qetësi.

Kërkimi i kuptimit të të rinjtë

Përgjatë historisë, një nga problemet thelbësore që janë përballur të rinjtë ka qenë qëllimi dhe kuptimi i kësaj jete. Pyetjet si: kush janë, nga kanë ardhur, përse ekzistojnë dhe në fund ku do të shkojnë i kanë ngacmuar gjithmonë mendimet e tyre dhe i kanë shtyrë drejt një kërkimi shpirtëror. Faktori më përcaktues në këtë çështje janë familja, mjedisi ku jetojnë, shteti, institucionet arsimore, kultura dhe gjendja shpirtërore që karakterizon qytetërimin, ndjenjat dhe mendimet, trashëgimia historike, traditat, besimet dhe ideologjitë, kushtet ekonomike dhe politike, morali, të drejtat dhe liritë themelore, eksperiencat, horizonti i njerëzve të suksesshëm, aftësitë, emocionet dhe arritjet në atë shoqëri. Për të rinjtë të cilët kërkohet kuptimin e jetës dhe ekzistencës së tyre, këto faktorë kanë një ndikim të rëndësishëm në botëkuptimin e tyre për jetën, vizionin, qëllimet, pritshmëritë, motivimin dhe zgjedhjet për të ndjekur apo jo kauza të caktuara.

Të rinjtë kur nuk gjejnë përgjigje bindëse, shpresëdhënëse, me horizont të gjerë, dhe udhërrëfyes në mjedisin ku jetojnë atëherë bien në kotësi, pesimizëm dhe dëshpërim duke qenë se nuk e planifikojnë jetën rreth disa idealeve dhe nuk i përdorin mundësitë dhe aftësitë në vendin e duhur. Si përfundim një pjesë e tyre e anashkalojnë këtë problem dhe të dëshpëruar përipiqen të plotësojnë nevojat e përditshme të jetës. Një pjesë tjetër e humbin kurajën, tërhiqen në vetmi duke mos pranuar këshilla, zhyten në lojëra dhe argëtime, rrëshqasin drejt veseve të këqija dhe duke u ndjerë të padobishëm, tërhiqen e shkëputen nga shoqëria. Ndërsa një pjesë tjetër keqpërdoret duke u bërë pjesë e lëvizjeve të dëmshme që qarkullojnë në shoqëri duke luftuar kundër vlerave të qytetërimit dhe kulturës së tyre. Kjo edhe i shkakton shumë probleme atyre edhe e përball shoqërinë në themelin e së cilës gjenden të rinjtë me shumë probleme materiale, shpirtërore, individuale, familjare, shoqërore, morale dhe juridike.

Periudha e injorancës: Të rinjtë dhe kuptimi i jetës

Problemi më i madh i të rinjve në kohën e profetit Muhamed a.s ishte në lidhje me kuptimin e jetës. Ata jetonin nën hijen e politeizmit që kishin trashëguar nga të parët e tyre të cilin e besonin pa qenë fort të bindur por që nuk kishin mundësi ta vinin pikëpyetje atë. Kështu ata nuk gjenin përgjigje bindëse në lidhje me shqetësimin për ti dhënë një

të argëtimit, rendin vazhdimisht pas urrejtjeve dhe hakmarrjeve të fisnore, mosbindjen dhe grabitjen e pasurisë së dobëtisë e quani trimëri dhe ne fund largoheshin nga kjo botë sikur të mos kishin jetuar. Por, pasi besuan mesazhin hyjnor ata, pavarësisht talljeve, përbuzjeve, përjashtimit, padrejtësive dhe torturave nuk e braktisën fenë dhe kauzën e tyre, u përpoqën me forcën e besimit kundrejt mohimit dhe padrejtësive, u munduan ta lexonin universin si një libër dhe filluan të kërkonin rrugët që të vërtetat që besonin, ndjenjat dhe mendimet e tyre ti përhapnin në të gjithë botën. Ideat e larta i kishin shpëtuar nga ndjenjat dhe mendimet e këqija, shpërdorimi i mundësive, veset e këqija, obsesionet dhe fiksionet që çdo moment të jetës ta vlerësonin në rrugën e së vërtetës. Tashmë për ta, një jetë re kishte nisur...

Ndryshimi që erdhi në pesë vitet e para

H. Xhafer do t'ia përshkruante kështu Nexhashiut, mbretit të Abisinisë, ndryshimin që pësoi rinia e qytetit të Mekës pasi njohën Profetin Muhamed a.s: "O Mbret! Ne ishim një shoqëri e zhytur në injorancë që adhuronim idhujt. Ushqeheshim me kufomat dhe bënim çdo ligësi. Shkëpusim marrëdhëniet me fafësin dhe i bënim keq komshinjtë tanë. Të fortët i shtypnin të dobëtët prej nesh. Ja kjo ishte gjendja jonë. Allahu i Lartësuar dërgoi nga mesi ynë një profet që njihej për sojin, drejtësinë, besueshmërinë, nderin dhe moralin e tij të pastër. Ai na ftoi të besojmë Allahu si Zot të Vetëm, ta adhurojmë atë dhe të braktisim adhurimin e idhujve. Na urdhëroi që të themi gjithmonë të drejtën, ti çojmë në vend amanetet, të jetojmë në harmoni me komshinjtë dhe të largohemi prej mëkateve dhe gjakderdhjes. Ai na ndaloi nga çdo lloj veprimi i pamoralshëm, gënjeshtër, haku i jetimit dhe shpifja ndaj grave të ndershme.

Disa shembuj të jetëve që ndryshuan

Omer Ibn-i Hattab

Ai punonte si çoban derisa të njihej me të Dërguarin e Allahut. Një djalosh i martuar në moshën njëzet e gjashtë vjeçare. Në një rënë anë përpiquej të mbante familjen e në anën tjetër torturonte skllavin e tij për shkakun se e braktisi idhujtarinë. Më pas do të vetëdijesohej për mesazhin hyjnor dhe do të besonte. Jeta e tij tashmë kishte marrë kuptim sikur të kishte lindur për herë të dytë. Tanimë përballëj me një qytet të tërë për përhapjen e të së vërtetës dhe drejtësisë. Për këtë kauzë kishte braktisur vendlindjen dhe ishte kthyer në njerëzit më të afërt të tij. Ishte pëlqimi hyjnor që potencialet e tij ti zhvillonte në mënyrë të vazhdueshme nën edukimin e Profeti a.s që do ta bënë atë drejtues

kuptim kësaj jete. Në atë kohë, ashtu sikurse nuk kishte libra dhe udhërrëfyes për jetën nuk kishte edhe ndonjë lëvizje intelektuale. Prej shekujsh në mesin e tyre nuk kishin dalë as personalitete të rralla dhe monumentale që ti merrnin shembull e të ecnin në gjurmët e tyre. Ata ishin rritur në një ambient shterpë ku mbretëronte injoranca dhe padrejtësitë, shoqëria ishte e përçarë dhe ndarë e në fise ku mbretëronin luftërat e brendshme, varfëria, skllavëria, racizmi dhe plaçkitja dhe shumica e tyre nuk mund të kryenin ndonjë mision edhe brenda fisit të tyre. Ata ishin shumë poshtë shoqërive në Perandorinë Perse dhe atë Bizantinë dhe jetonin duke qenë të përbuzur prej tyre. Por në fakt, ata ishin të rinj me kapacitetin për të qenë drejtues shtetesh dhe ushtrish, mësues për popujt, dhe për ti dhënë zgjidhje problemeve madhore.

Të rinjtë që nuk kishin një qëllim dhe kuptim për jetën së tyre i shteronin emocionet, ndjenjat, kohën dhe mundësitë në rrjedhën e jetës së përditshme. Kështu ata bëheshin të varur ndaj pasioneve dhe dëshirave e bënë një jetë të zhytur në lojë dhe argëtim. Por shpirtrat e tyre ishin të etur dhe të trazuar, ëndrrat në zbrazëti dhe të dëshpëruara dhe zemrat të shqetësuara. Pikërisht përballë këtyre të rinjve erdhi i Dërguari i Allahut i cili prezantonte një botëkuptim për jetën që shpjegonte kuptimet e fshehta të krijimit, mësonte urtësitë e jetës, prezantonte para tyre qëllime universale dhe të përjetshme, i nxiste drejt reflektimit dhe kërkimit të diturisë, orientonte vullnetin e tyre për ta përdorur në punë të dobishme në shërbim të vetes, familjes, shoqërive dhe të gjithë njerëzimit, nxiste përpjekjen me të gjitha mundësitë materiale dhe shpirtërore në ndërtimin e një bote më të mirë dhe përmirësimin e shoqërive. Ai i ftoi ata që nëpërmjet përfaqësimit dhe kumtimit të fesë që ti jepnin fund në mënyrë të drejtë dhe të natyreshme padrejtësive, mëkateve, shkatërrimeve dhe përçarjeve nëpër botë, i lironte ata nga gjërat që i kishin kthyer në robër të kulturës së injorancës dhe kënaqësive të përkohshme duke e formësuar jetën nëpërmjet besimit të Allahut që ka krijuar gjithçka dhe fitimit të botës tjetër, jetësimin të vlerave më të larta dhe përcjelljes së tyre te njerëzit e tjerë.

Profeti Muhamed a.s me ngrohtësinë e përfaqësimit të fesë dhe strategjitë e kumtimit, kishte ndikuar aq shpejt te të rinjtë sa që ata vrapuan drejt tij sikur banorët e një bote të errët që prej vitesh prisnin shfaqjen e agimit. Deri dje, ata të rinj ecnin të përhumbur në shkretëtirë, silleshin rrugëve të dehur nga pija, harxhonin jetën në vende

të gjithë myslimanëve. Ai arriti të gjunjëzonte një për një mbretëritë e asaj kohe që ishin zhytur në padrejtësi. Një ditë prej ditësh, ndërsa po ligjëronte hutben përpara popullit, kishte ndër nevojën për tu kthyer pas në kohë dhe për t'ia kujtuar vetes së tij gjendjen përpara se të njihet me Profetin Muhamed a.s. duke thënë: " Deri dje ti ishe vetëm një çoban që kujdeseshe për devetë e Hattabit!" Kështu nëse nuk do të njihet me Profetin Muhamed a.s dhe botëkuptimin për jetën në të cilin ftonte edhe ai si të parët e tij dhe shumë të tjerë do të mbetej ashtu, në atë gjendje përgjithmonë.

Hamza Ibn-i Abdilmuttalib

Në vitet e rinisë nuk kishte mundur të gjente një udhërrëfyes që t'ia shpjegonte të vërtetat e kësaj jete. Kështu ia kishte dhënë veten pijes dhe qëndrimin në shkretëtirë duke e harxhuar jetën e tij në gjueti. Po jetonte momentet e fundit të rinisë së tij. Një ditë, nipi i tij, Muhamedi i Besueshëm ishte kthyer nga shpella Hira me mesazhin që shpjegonte kuptimin e kësaj jete dhe udhërrëfente rrugën për në botën e përtejme. Edhe pse ishte e vështirë ti linte zakonet, ai i kishte reflektuar thelle thellë gjatë netëve që kalonte në shkretëtirë mbi të vërtetat që i ishin kumtuar dhe kishte kuptuar që kishte ardhur në këtë jetë plot kuptim për të arritur qëllime të larta dhe të amshueshme. E kishte lënë harkun dhe shigjetën dhe kishte rënë në kërkim të lumturisë së përjetshme. Hamzai që deri dje gjuante luanët, deri sa të hapte krahët drejt përjetësisë duke rënë dëshmor në Uhud, kishte qëndruar në këtë rrugë i palëkundur duke udhëtuar në amshim si "Luani i Allahut".

Djelmohat e fisit Evs dhe Hazrexh dhe konflikti i tyre

Djelmohat e fiseve Evs dhe Hazrexh i kishin humbur baballarët në luftën e brendshme midis tyre. Të frustruar dhe me shpirt të trazuar nga gjakmarrja dhe luftërat e vazhdueshme midis tyre, ata ishin në kërkim të një kuptimi për jetën. Kur i Dërguari i Allahut shkoi në Medinë, i nxiti të hiqnin dorë rruga e baballarëve të tyre dhe i propozoi ta mbushnin jetën e tyre me mirësi dhe punë të dobishme duke i ftuar në botën universale të islamit. Ata u bindën nga Profeti Muhamed a.s, e braktisën sherrin dhe gjakmarrjen duke u futur në rrugën e tij për të filluar një jetë të re.

Shembujt e ndryshimit që solli Profeti Muhamed a.s nëpërmjet paraqitjes së një kuptimi në lidhje me jetën janë aq shume sa vetë numri i sahabëve. Të rinjtë që lindnin dhe rriteshin në qytetin e Mekës dhe Medines jetonin si një idhujtar, skllav, bujk, çoban, ose tregtar dhe iknin

pa lënë asnjë gjurmë në historinë e njerëzimit. Kurse mesazhi që përcolli Profeti ynë dhe jeta në të cilën i ftoi, formësoi edhe njëherë karakterin, personalitetin dhe ëndrrat e tyre, arritën majat në fusha të ndryshme të jetës, ndryshuan rrjedhën e historisë, arritën të gjunjëzonin perandoritë ekzistuese dhe themeluan një qytetërim të ri. Ata i ndriçuan popujt me dituri, përçuan besimin dhe drejtësinë kudo që shkuan, fituan zemrat e njerëzve, drejtuan dhe udhërrëfyan brezat e tjerë. Si rrjedhojë, varret e tyre gjenden sot në stepat e Azisë, rrëzë maleve të Siberisë, në portet e Kinës, thellësitë e Afrikës dhe në dyert e Stambollit.

Përfundim

Rinia është një periudhë shumë kritike dhe e rëndësishme duke qenë se këndvështrimi, qëllimet, synimet dhe ëndrrat që përftohen në këtë periudhë formësojnë pjesën tjetër të jetës së njeriut. Për këtë arsye duhet të interesohemi nga afër për të rinjtë që hyjnë në një kërkim në këto vite, duke mos i lejuar të hyjnë në konfuzion në lidhje me personalitetin dhe identitetin e tyre, duke i dhënë përgjigje bindëse dhe gjithëpërfshirëse, duke i prezantuar qëllime për të cilat të nesërmen të jenë të kënaqur, duke i edukuar dhe përgatitur që të jenë të dobishëm për shoqërinë dhe të gjithë njerëzimin, dhe duke krijuar një ambient të përshtatshëm dhe kushte sociale për të zhvilluar veten dhe përçaruar vlerat e tyre të tjerët.

Në këtë kuptim, i Dërguari i Allahut iu prezantua të rinjve me të vërtetat që i jepnin kuptim jetës në të gjitha dimensionet e saj, fitoi zemrat e tyre dhe vendosi në shpirtrat e tyre vetëdijen për kauzën, nuk i dorëzoi ata në atmosferën e injorancës, u interesua nga afër me ta, i edukoi dhe i angazhoi në punë të dobishme për shoqërinë duke i frymëzuar gjithmonë drejt qëllimeve të larta.

Bashkë me Profetin a.s të rinjtë patën mundësinë që pjesën tjetër të jetës ta shfrytëzonin në formën më të mirë duke ruajtur qëndrueshmërinë, ku në njërin anë vraponin drejt adhurimit të Allahut dhe në anë tjetër arritën të bënin shumë puna të mëdha dhe të dobishme. Edhe në ditët e sotme, gjëja e parë që duhet bërë me të rinjtë është që duke i shpjeguar në mënyrë të drejtë se kush është njeriu, nga ka ardhur, qëllimin e jetës dhe se ku do të shkojë, të pajisen me qëllime të larta për jetën e tyre. Në këtë kontest duke mos i lënë të pa orientuar, të rinjtë duhen ushqyer në aspektin shpirtëror në kohën e duhur në mënyrë që çdo moment i jetës së tyre të jetë i mbushur me kuptim dhe mirësi që rrezatojnë për të gjithë njerëzimin.

Abdullah Bulku

Disa mesazhe nga rinia e profetit Ibrahim (a.s.)

Në këtë shkrim do të nxjerrim disa mesazhe nga rinia e profetit Ibrahim a.s. Ai mendohet të ketë jetuar një jetë relativisht të gjatë, rreth 170 vjeçare. Ai u lind në qytetin Babil të Babilonisë së hershme, pra në Irakun e sotëm. Në atë vend të gjithë adhuronin statujat dhe yjet. Besim ky, që për llogjikën dhe zgjuarsinë e Ibrahimin a.s ishte i papranueshëm. Sepse ai ishte njeri racional dhe shumë i zgjuar që në moshë të vogël.

Këtë e shikojmë në momentin kur ai i drejtohet babait të tij idhujtar duke i thënë:

"O Babushi im, përse adhuron atë që as dëgjon, as nuk sheh dhe as nuk të bën dobi?" (Merjem, 42)

Meraku dhe racionaliteti që në moshë të vogël, e bëri atë të meditante sistematikisht për mundësinë e të qënurit Zot të një ylli, hënës apo diellit. Dhe si rezultat i këtij meditimi ai tha se Zoti im nuk mund të lind dhe të perëndoi, **"Unë i drejtohem Atij që krijoi qiejt e tokën dhe kurrë nuk do të jem prej idhujtarëve!"**

Siç e shikojmë, etapën e parë të thirrjes ai e fillon me babain e tij idhujtarë, i cili njëkohësisht ishte dhe skulptori dhe kujdestari i idhujve. Këtu vlen të theksohet mënyra e butësisë së fjalëve leduese të tij kundrejt babait. Duke ju drejtuar me: **"O babai im, unë kam frikë se do të godet ndonjë dënim prej të Gjithëmëshirshmit e do të jeshë shok i djallit!" (Merjem, 45)**

Kjo mënyrë e të foluri tregon një edukatë të lartë që posedonte ky profet i madh. Nga njëra anë na mëson mënyrën e sjelljes kur ftojme dikë në fe, nga ana tjetër na mëson së si duhet ti respektojmë prindërit edhe nëse ata janë jobesimtarë.

Në ditët e sotme respektimi i prindërve është me të vërtetë një problem serioz. Njeriu sado i mirë dhe i devotshëm të jetë në adhurime kundrejt Zotit, nëse nuk sillet mirë me prindërit, besimtarë apo jo qofshin ata, ngjason me një enë të shpuar që në fund të ditës është përsëri bosh dhe nuk i mbetet asnjë sevap.

Shkruhet në libra se, kur Imam Shafiu hante bukë me nënën e tij në të njëjtën sofër, ai vetëm rrinte duke e shikuar. Kur e pyeste ajo se përse nuk ha, ai i përgjigjej: **"Mos u mërzit se ja do të filloj,"** dhe vazhdonte të mos hante edhe pse ishte i uritur. Pasi përfundonte nëna së ngrëni, fillonte dhe hante. Kur e pa nëna që tani filloi të hajë, e pyeti për shkakun. Imam Shafiu iu përgjigj: **"Kisha frikë se mos më kap dora diçka që të pëlqen ty".**

Ja pra ky është Islami, kjo është feja që ka zgjedhur Zoti për ne. Besoj se, gjithësecili prej nesh e bën vetë krahasimin e duhur më gjëndjen tonë aktuale dhe asaj ç'ka na mëson Kurani nëpërmjet historive të profetëve.

Motra dhe vëllezër të nderuar Nëse dikush nga ne ka nga njerëzit e afërt, nënë, baba, motër, vëlla e kështu me radhë, të cilët nuk e njohin Zotin dhe janë duke ecur me vetëdije apo jo, në një rrugë të gabuar, le të shikoi me vëmendje historinë e Ibrahimit a.s. Aty do të mësojmë se, me njerëzit dhe sidomos me prindërit, duhet me qenë patjetër i butë, i ëmbël, i dashur dhe i sinqertë.

Ibrahimi a.s. në zjarr

Kemi përmendur më sipër se Ibrahimi a.s, që në moshë të re e nisi ftesën për në besim të pastër monotesit me



babain e tij. Pasi nuk u pranua nga i ati, ai vazhdoi të ftonte të gjithë njerëzit haptazi, madje me shumë delikatesë dhe racionalitet, sa që dhe vetë ata edhe pse dorëzoheshin përballë fakteve që ai i jepte, nuk e pranonin besimin e tij sepse e shikonin si ofendim të braktisin atë çka besonin të parët e tyre dhe vetë ata. Madje një pjesë e mire e tyre nuk besonin nga frika që kishin ndaj Nemrudit, asokohe mbret i Babilonisë i cili pretendonte dhe i detyronte njerëzit të besonin atij si Zot. Por edhe pse moshë e Ibrahimit a.s ishte shumë e re, ai u fliste atyre me bindje të plotë në atë çka i besonte, madje duke marrë parasyshtë edhe armiqësinë që mund të tregonte vetë mbreti Nemrud. Ajo që i jepte atij këtë kurajo dhe guxim, ishte bindja e tij për vërtetësinë e krijuesit suprem, Allahut të madhëruar dhe dashuria për besimin e pastër që i kishte stërmëbushur zemrën.

Një ditë Ibrahimit a.s theu të gjithë idhujt përveç njërit, me qëllim që ti jepte një mësim, se nuk mund të jetë Zot ai që nuk mund të mbroji as veten e vet. Dhe më pas i tha:

“A po e adhuroni atë që vetë e keni gdhendur? (Saffat, 95)

Milëfi, inati dhe urrejtja e tyre bashkë me të mbretit Nemrud, bëri që të vendosin ta digjin në zjarrin më të madh që kishte ndezur ndonjëherë njerëzimi. Zoti e përshkruan me këto fjalë në Kurandin Famëlartë:

“Ata thanë: ndërtoni një ndërtesë të madhe dhe hidheni që andej në zjarr” (Saffat, 97)

Ndërkohë, gjatë kohës së ndërtimit të vendzjarrit, që mori muaj për tu përgatitur, Ibrahimit ndodhej në burg, i izoluar, me qëllim që të mos ndikonte tek njerëzit. Në momentin që do ta hidhnin në zjarr, njerëzit talleshin me

të duke e qeshur, duke e ofenduar dhe duke i thënë se, ti akuzove Zotat tanë që nuk kanë asnjë dobi, le të shikojmë Zotin tënd sa dobi do të ketë për ty. Përballë një situatë të tillë, ku çdo gjë ishte kundër favorit të tij, ai vetëm se thoshte me zë të lartë: **“Hasbije-Allahu ue ni'mel uekiil”**

“Më mjafton Allahu, Ai është shoku, garantuesi më i mirë” (Ali Imran, 173)

Si përfundim, atë e hodhën në zjarrin e madh i cili zgjati të jetë i ndezur për 3 ditë. Pas 3 ditësh profeti i Zotit del nga mezi i zjarrit i lumtur dhe duke buzëqeshur. Ai që e mbrojti nga zjarri duke e urdhëruar atë

“O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!” (Enbija, 69) ishte po Ai që i tha detit të hapet për Musain, Ai që i tha balenës qëllite por mos e vrit Junusin, Ai që nënshtoroj erën, kafshët, shpendët dhe xhindët ndaj Sulejmanit, Ai që i tha thikës mos e prit Ismailin, Ai që nga qielli zbriste sofrën ushqimi për Isain dhe po Ai që nënshtroi kohën, largësitë, lartësitë dhe ligjet e fizikës duke e ngjitur në qiellat më të larta profetin e fundit Muhamed Mustafanë s.a.s.

Prandaj dhe të nderuar miq!

Se pari ja dëshiroj vetes time, më pas edhe ju, që të përpiqemi me ngulm për t'iu dorëzuar plotësisht Atij, Atij i cili është i vetmi që meriton të adhurohet, pra Allahut të madhëruar. Me shpresën që ky dorëzim si i Ibrahimit a.s, të na surprizoi në momente të vështira të kësaj bote por mbi të gjitha të na surprizoi në botën e përtejme. Amin.

Tauland Bica

HALID BIN UELIDI PRANON ISLAMIN

Halidi (radjallahu anhu) tregon: “Kur Allahu vendosi më të mirën për mua, duke më hedhur në zemër një shkëndijë dashurie për Islamin, atëherë mund të them se më erdhi mendja në vend. Thashë njëherë me vete: ‘Unë kam marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë bërë kundër Muhamedit. Sa herë që kthehesha nga lufta, e ndieja se isha duke u munduar për një punë të kotë dhe e shihja se herët a vonë do të ishte Muhamedi ai që do të dilte ngadhënjimtar.’ Kur Resulullahu u doli në Hudejbije, mora edhe unë një grup kalorësish dhe dola atje. Atë e hasa në vendin e quajtur Usfan, ishte bashkë me disa nga sahabët e tij. Bëra ca hapa përpara, në mënyrë që të ishim në të njëjtin drejtim e ai të mund të më dallonte. Doli përpara tyre dhe u fali atyre namazin e drekës. Edhe pse donim t’i sulmonim, e kishim të pamundur. Kjo duhet të kishte një domethënie të veçantë. Duhet ta kishte kuptuar se ç’kishim në mendje, që i lidhi të dy namazet me njëri-tjetrin, duke u falur sahabëve edhe namazin e ikindisë. Kjo më preku shumë; ‘këtë njeri vërtet që e mbron një Fuqi e veçantë.’”

U largua nga ne, duke marrë në të djathtë. Kur bëri paqe me kurejshët në Hudejbije dhe kurejshët e detyruan të kthehej mbrapsht, andej nga kishte ardhur, atëherë thashë me vete: “E ç’më mbeti mua? Po tani, ku të shkoj? A të shkoj te Nexhashiu? Po edhe ai i besoi Muhamedit dhe tashmë tek ai jetojnë të sigurt edhe sahabët. Të shkoj te Herakliu, të braktis fenë time e të pranoj të bëhem i krishterë ose jahudi? Apo të qëndroj në Iran? Apo të kthehem në Mekë, dhe të qëndroj në vendlindjen time, bashkë me të tjerët, njësoj si ta? Dhe, ja, teksa mendjen e kisha të zënë me gjithë këto mendime, në Mekë po vinte Profeti për të bërë kazanë e umres që nuk e kishte bërë dot një vit më parë, si pasojë e Marrëveshjes së Hudejbijes. Duke qenë se atëherë përpiqesha të mos takohesha me askënd, as atë nuk e pashë dot. Në Mekë, bashkë me të Dërguarin e Allahut kishte ardhur edhe vëllai im, Uelid bin Uelidi, i cili më kishte kërkuar gjithandej dhe kur

nuk më kishte gjetur dot, kish lënë këtë letër:

“Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit... Nuk kam parë ndonjëherë gjë më të habitshme se kjo; si ka mundësi që një njeri si ti, kaq i zgjuar, i shmanget Islamit, duke u rrekur që si e si që të mos e pranojë atë. Kush është ai njeri që mund të dojë të mbetet i paditur karshi një feje si Islami? I Dërguari i Allahut më ka pyetur, ‘Ku është Halidi?’, – dhe unë gjithmonë i jam përgjigjur: - ‘Do ta sjellë Allahu.’ Ndërsa ai më thotë gjithmonë: - ‘Si ka mundësi, është shumë për t’u habitur që një njeri si Halidi të mos e kuptojë e të mos e pranojë Islamin! Sikur me trimërinë dhe seriozitetin e tij të gjendej në radhët e myslimanëve, kjo do të kishte qenë shumë herë më e mirë për të, e ne do ta mbanim atë më lart se të tjerët.’ Kështu që, vëllai im, të duhet të heqësh dorë e të mos i humbasësh më të gjitha këto të mira e mbarësi që të kanë aq shumë hije.”

Halid bin Uelidi (radjallahu anhu) thotë se: “Kur më erdhi letra që vëllai kishte lënë për mua, seç ndjeva njëfarë lehtësimi dhe më dukej se tani mund të dilja mes njerëzve. M’u shtua edhe më shumë simpatia për Islamin. Ndërsa fakti që vetë Resulullahu kishte pyetur për mua me emër më gëzoi pa masë. Në ëndërr pashë sikur nga mesi i një shkretëtire të ngushtë dhe të thatë dola drejt një vendi të gjelbër e të paanë dhe në shpirt seç më vetiu sikur ‘kjo ëndërr do të bëhej realitet.’ Kur të shkoj në Medinë, do t’ia tregoj ëndërrën njëherë Ebu Bekrit. Ia tregova dhe ai ma interpretoi kështu:

- “Ai vend i gjelbër, plot gjelbërim, dhe i gjerë e i paanë është shenjë se Allahu ka vendosur udhëzimin tënd në Islam. Ndërsa vendi i ngushtë ku je tani është idhujtaria.”

“Kur vendosa të dilja përpara të Dërguarit të Allahut, me kë të shkoj thashë me vete. Në rrugë u hasa me Safuan bin Umejen. E pyeta: “O Ebu Uehb, a nuk e sheh se si jemi katandisur, kemi mbetur një grusht njerëzish; po sikur të shkojmë e t’i besojmë Islamit! Nderimet për Muhamedin do të jenë edhe nderimet tona!” Si i çmeritur m’u përgjigj: “Sikur

të gjithë t'i bashkohen atij dhe të mos mbetet askush tjetër përveç meje, prapë as nuk e pranoj, as nuk e ndjek!"

U ndamë nga njëri-tjetri. Me vete thashë: "Ky ka humbur vëllanë dhe babanë në Bedër." Takova djalin e Ebu Xhehlit, Ikrimen, e edhe atij të njëjtat gjëra i thashë. Edhe ai m'u përgjigj po njësoj. – "Mirë.", – i thashë Ikrimes, – "këto që folëm të mbeten mes nesh." – "Në rregull, mos ki merak.", – m'u përgjigj. Shkova në shtëpi dhe u kërkova që të më përgatitnin kafshën, se do të nisesha për rrugë. U nisa. Në rrugë rastisa Osman bin Talhanë. Me vete thashë, "ky është shoku im, po sikur t'ia them ato që më shkojnë nëpër mend." Pastaj, kur kujtova se edhe atij i ishin vrarë shumë kushërinj, u stepa. Do të vazhdoj rrugën, pastaj i thashë vetes: "Ç'të duhet ty me kushërinjtë e tij, më e mira është t'i them njëherë."

– "Ne jemi si dhelpra në fund të pusit, që po të hedhë dikush një kovë me ujë, dalim menjëherë.", – i thashë atij, duke shtuar edhe të gjitha ato që u kisha thënë dy miqve të mi. Ai e pranoi menjëherë ftesën time.

– "Unë u nisa sot dhe dua të vazhdoj rrugën, ja ku e kam edhe kafshën e transportit.", – i thashë.

U morëm vesh dhe e lamë të takoheshim në vendin e quajtur Jexhuxh. Kush mbërrinte i pari do të priste tjetrin. U nisëm në agim. Ende pa dalë mirë dielli, u takuam me njëri-tjetrin, siç e kishim lënë, në Jexhuxh. Vazhduam rrugën pa ndërprerje, deri kur mbërritëm në Hide. Atje u takuam me Amr bin Asin. – "Mirë se keni ardhur.", – na tha. – "Mirë se ke ardhur edhe ti.", – ia pritëm edhe ne.

– "Për ku jeni nisur kështu?", – na pyeti Amri.

– "Po ty ç'të ka shtyrë që e ke marrë këtë rrugë?", – i thamë ne, por edhe ai të njëjtën pyetje na bëri.

– "Kemi ardhur të pranojmë Islamit dhe t'i besojmë Muhamedit.", – iu përgjigjëm ne.

– "Edhe mua po i njëjti mendim më ka shtyrë që ta marr këtë rrugë.", – qe përgjigja e tij.

Kështu u bëmë bashkudhëtarë, sepse të gjithë rrugën e

mbetur deri në Medinë e bëmë të pandarë nga njëri-tjetri. Kur erdhëm, me sa dukej atë e lajmëruan menjëherë. Edhe ai ishte kënaqur shumë për ardhjen tonë. Veshja menjëherë rrobat më të mira që kisha marrë me vete dhe u nisa duke ecur, të shkoja te Resulullahu. Doli të më priste vëllai im Uelidi, duke na thënë: – "Nxito! I Dërguari i Allahut ka marrë vesh se ke ardhur ti dhe është shumë i kënaqur; po ju pret!"

Aty i nxituam hapat. Shkova menjëherë pranë tij. Më buzëqeshte pareshtur. Qëndrova mu përballë tij; unë e përshëndeta atë ashtu siç përshëndeten profetët. E pranoi përshëndetjen tonë me atë buzëqeshjen e tij aq të bukur. Unë i thashë: – "Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut, që meriton të adhurohet dhe nuk ka kurrfarë dyshimi se ti je i Dërguari i Allahut."

– "Eja, lëvduar qoftë Allahu që të udhëzoi ty në të drejtën. Të kam njohur përherë si njeri të zgjuar. Gjithmonë kam dashur që ajo mendje të të printe ty veçse kah më e mira!", – m'u përgjigj ai.

– "O Resulallah, në çdo luftë që është bërë me ty, unë kam parë se unë luftoja me të Drejtën (Hakk'un-Allahun) më shumë nga inati. Lutju Allahut, që të m'i falë mëkatet që kam bërë."

– "Me Islamit fshihen të gjitha mëkatet e bëra para pranimit të tij, o Halid. Megjithatë, mirë është që ju të vazhdoni t'i luteni Allahut që Ai t'ju falë!"

Nuk ma prishi dhe filloi të lutej: "O Zoti im! Falja Halid bin Uelidit të gjitha të këqijat e ato që ka bërë për t'i larguar njerëzit nga udha Jote!"


Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"

M. Jusuf Kandeheui

Botim i KMSH

Rëndësia e namazit të Teravisë





Fjala Teraviih është shumësi i fjalës arabe "terviha" dhe ka kuptim "të pushosh, apo të qetësohesh". Gjatë muajit të Ramazanit, pas namazit të jacisë, ulja në teshehud pas çdo katër rekateve është quajtur terviha, ku më vonë shumësi i kësaj fjale i njohur me emrin Teraviih, ka marrë emrin e namazit shtesë që falet në netët e Ramazanit.

Teravitë janë sunet muekkede (të forta). Është sunet për muajin e Ramazanit, për meshkujt dhe për femrat dhe nuk ka të bëjë me agjërimin. Namazi i teravive përbëhet nga 20 rekate që falen pas namazit të jacisë dhe para namazit të vitrit. Falja e teravive me xhemat është më e pëlqyeshme. Teravitë falen me 10 selame dhe ndërmjet tyre bëhen 5 pushime të shkurtra. Pra, jepet selam në çdo dy rekate dhe pushohet në çdo katër rekate, por selami mund të jipet edhe pas katër rekateve. Pas pushimit të pestë plotësohet edhe falja e vitrit me xhemat. Profeti (a.s.) përveç disa netëve, teravitë i ka falur vetëm dhe për t'i motivuar sahabët në faljen e tyre, ka thënë: "Kush e fal namazin e Ramazanit (teravisë) duke shpresuar tek Allahu, atij do t'i falen të gjitha gjynahet e bëra më parë" (Buhari, Salatu't-teraviih, 1; Muslim, Salatu'l-musafirin, 174).

Transmetimi që flet për praktikën e teravive nga Profeti (a.s.), është i tillë: Profeti ynë në muajin e Ramazanit kishte përgatitur një dhomë të shtruar me rrogözë për të bërë itikaf në xhaminë e tij. Disa netë në 10 ditët e fundit të Ramazanit, është bashkuar me xhematin duke dalë për të falur namazin e jacisë dhe të teravisë. Një natë kur pa interesimin e madh të njerëzve, fali vetëm namazin e jacisë dhe u fut në dhomën e tij, duke mos e plotësuar teravinë me ta. Me shpresë se do të dalë sërish, njerëzit e pritën aty, madje disa prej tyre duke menduar se ai po flinte kishin filluar të kolliteshin me qëllim që ai të zgjohej. Profeti (a.s.) kishte dalë nga dhoma dhe u kishte thënë këto fjalë: "Unë e

di dëshirën tuaj për të falur teravitë. Dhe nuk kam asnjë pengesë për ta falur këtë namaz bashkë me ju. Por, nga frika se mos teravitë do të bëhen farz për ju, nuk dola t'i fal ato. Po që se ju bëhet farz, ju nuk do të mund ta zbatoni. Tani shpërndahuni! Përveç farzeve, namazet më me vlerë janë ato të falura në shtëpitë tuaja" (Buhari, Salatu't-teraviih 2; Muslim, Salatu'l-musafirin, 178).

Po ashtu, Profeti (a.s.) për rëndësinë e faljes së teravive dhe të qenurit sunet të tyre, është shprehur: "Allahu jua ka bërë farz agjërimin në muajin e Ramazanit. Ndërsa unë ju motivova që netëve të Ramazanit të falni namazin e teravive si sunetin tim. Kush agjëron me sinqeritet dhe duke besuar e pritur sevapet e Allahut si dhe duke falur namazin e teravisë, pastrohet nga mëkatet si të kishte lindur sot nga nëna e tij" (Nesai, Sijam, 40; Ibn Maxhe, Ikame, 173; Ahmed b. Hanbel, Musned, 1/191).

Sipas Hanefive, Shafive dhe Hanbelive namazi i teravive është me 20 rekate. Ndërsa Malikitë kanë mendimin se teravitë janë me 20 ose 36 rekate. Por sipas disa librave të këtij medhhebi teravitë pranohen me 20 rekate. Imami më i rëndësishëm i medhhebit Shafi, Imam Neveviu, ka thënë se namazi i teravisë mbështetur në konsensusin e dijetarëve islamë, është me 20 rekate dhe është sunet.

Omeri (r.a.), nën drejtimin e Ubej bin Ka'bit, i kishte grumbulluar sahabët duke falur me ta 20 rekate teravi dhe askush prej tyre s'e kishte kundërshtuar një praktikë të tillë. Kjo gjendje tregon se ata dinin diçka në lidhje me këtë çështje.

Si rrjedhojë edhe Ebu Hanife, duke tërhequr vëmendjen në këtë ngjarje thekson se Omeri (r.a.) nuk e nxori nga mendja e tij këtë ide dhe nuk mund të ketë sjellë ndonjë risi, por është bazuar në të dhënat dhe mësimet e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Edhe sahabët, duke parë këtë

vendim me vend të Omerit (r.a.) e kanë mbështetur atë duke unifikuar mendimet e tyre. Baza mbështetëse e këtij konsensusi është praktika e Profetit (a.s.). Konsensusi i tyre në këtë çështje është si argument i fesë. Në këtë mënyrë ka filluar të falet namazi i teravive me 20 rekate, duke u bazuar në konsensusin dhe praktikën e tyre nëpër xhami, e cila vazhdoi më vonë edhe në kohën e Osmanit (r.a.) dhe të Aliut (r.a.), për të ardhur deri në ditët e sotme në të njëjtën mënyrë.

Si rrjedhojë, edhe Ibni Abidini e thekson një gjë të tillë duke përmendur se kjo praktikë ndiqet si në Lindje ashtu edhe në Perëndim.

Omeri (r.a.) urdhëroi faljen e teravive me 20 rekate në xhami, për të parandaluar rrëmujën. Sepse teravitë në fillim faleshin në xhami vetëm apo edhe me xhemat, në mënyrë të shpërndarë.

Ekzistojnë transmetime të tjera që mbështesin faljen e teravive me 20 rekate nga sahabët. Ja disa prej tyre:

1- Nga Ibni Abasi (r.a.) transmetohet se Profeti (a.s.) gjatë Ramazanit ka falur 20 rekate dhe vitrin (Abd b. Humejd, Musned, I/218; Taberani, Muxhemu'l-Evsat, V/324; Muxhemu'l-Kebir, XI/393; Ibn Ebi Shejbe, Musannef, II/164). Ky transmetim është i përforcuar me konsensusin në praktikë të sahabëve. Sepse

transmetimi i Aishes (r.a.) se Profeti (a.s.) gjatë Ramazanit falte shumë namaz, konsensusi i sahabëve, duke falur 20 rekate dhe unifikimi i mendimit nga ana e dijetarëve në lidhje me faljen e 20 rekateve të teravive, e përforcon transmetimin e Ibni Abasit në lidhje me këtë çështje. Të sipërpërmendurit janë argument për saktësinë e hadithit të mësipërm. (Kandehlevi, Evxhezu'l-Mesalik ila Muvatta Malik, 2/286)


2- Transmetohet nga Said bin Jezidi (r.a.) se në kohën e Omerit (r.a.) falnin 20 rekate dhe vitrin (Bejhaki, Sunenu'l-Kubra, 2/496; Zejlai, Nasbu'r-Raje, 2/175; Tehanevi, l'lau's-Sunen, 7/60).

Para 200 vjetësh kanë dalë disa dijetarë në Indi që kanë predikuar për ta falur Teravinë me tetë rekate për lehtësim e pëlqim të njerëzve, gjë që u përhap edhe në disa vende arabe. Ne duhet ta kemi të qartë se sahabët kanë qenë më të ditur e më të interesuar për fenë se ata dhe se mijëra dijetarë të vendeve të ndryshme. Namazi i teravisë ka qenë falur dhe falet me njëzet rekate edhe në vatrën e Islamit, në Meke-Medine.

Si përfundim, namazi i teravive është sunet dhe është nga simbolet e Islamit. Ai ka 20 rekate.

Eduart Demiraj





HAFIZ ISMET DIBRA

(1886-1955)

Hafiz Ismet Dibra lindi në Dibër në vitin 1886, ku kreu mësimet fillestare, pastaj Medresenë, ku mësoi përmendësh Kur'anin e Madhëruar, e fitoi titullin Hafiz, një titull i nderuar.

Studimet e larta i kreu në Stamboll, në kryeqytetin e Perandorisë, por edhe pse i ofruan katedrën, në një shkollë të lartë të Stambollit, nuk qëndroi aty sepse kishte vendosur t'i shërbente Shqipërisë...

Dibra është vendlindja e H. Hafiz Ismet Dibrës, Stambolli është vendi ku kreu studimet e larta, ndërsa Tirana, është vendi ku zhvilloi veprimtarinë e tij. Revista "Zani i Naltë" është tribuna ku shpalosi njohuritë e tij në fushën e legjislacionit islam, të filozofisë islame, tefsirit, hadithit, logjikës, teorikës, etj. Medreseja e Naltë e Tiranës që institucioni ku ai zbatoi në praktikë edukatën islame dhe mjeshtërinë e mësimdhënies. Kishte një kulturë të gjerë, një qëndrim demokratik dhe patriotik. Zotëronte më së miri gjuhën arabe, perse dhe atë turke (osmane).

Në mars 1923 u zhvillua Kongresi i Parë i Myslimanëve Shqiptarë në Tiranë, duke zgjedhur Kryetar të Bashkësisë Islame, Kryemyftiun Haxhi Vehbi Dibrën. Në tetor të vitit 1923 doli në dritë revista "Zani i Naltë", organ zyrtar i Komunitetit Mysliman Shqiptar. Me 1 mars 1924 iu besua drejtimi i Medresesë në Tiranë z. Qamil Bala dhe në vitin 1930, kjo detyrë iu besua Hafiz Ismet Dibrës, duke u bërë drejtori i dytë i saj. Duke ndjekur traditat e të parit aktivizoi trupin mësimor, personel të përgatitur siç qenë: Hafiz Ali Korça, Haki Sharofi, Sheh Qazim Hoxha, etj.

Në Medresenë e Tiranës, përveç lëndëve fetare si Kur'ani, Hadithi, Tefsiri, Fikhu... mësohej historia, gjeografia, aritmetika, gjeometria, etj.

Në tërë veprimtarinë e tij ai udhëhoqë nga mësimet e Kur'anit dhe në përshtatje me përbërjen e popullit shqiptar ai nisej nga toleranca mes besimeve dhe besimtarëve. Medreseja e Tiranës, e drejtuar nga H. Ismet Dibra, ruante dhe vazhdonte traditën e edukimit të nxënësve, krahas asaj të fesë, dhe të frymës patriotike dhe kalitjes së ndërgjegjes kombëtare.

H. Ismet Dibra vizitoi edhe vendet e shenjta në Mekë dhe Medine, duke u bërë Haxhi.

Në vitet '30 të shekullit XX zhvilloi një aktivitet të gjerë intelektual, fetar e patriotik. Janë të përmendura ligjëratat e tij të njëpasnjëshme që

patën për subjekt temën "A ka dyshim në qenien e Zotit?" Në këto ligjëratat Hafiz Ismet Dibra, duke u mbështetur në ajetet e Kur'anit, zbërtheu shumë teza dhe koncepte që në ato vite ishin bërë objekt bisede në qarqet intelektuale. Ligjëratat bënë pjesë në luftën që elita islame po i shpallte ideve komuniste, që kishin filluar të përhapeshin në Shqipëri. Hafiz Ismet Dibra iu referua shumë figurave të shquara të rrymave të ndryshme filozofike si: Dekartit, Berksonit, Spenserit, etj.

Më vonë ato ligjëratat u botuan në faqet e "Zanit të Naltë" dhe më 1993 u botuan edhe në Miçigan të SHBA-së. Hafiz Ismet Dibra në libër bën thirrje që të shihet e vërteta, të hiqen syzet e errëta. "Me syze të errëta, - shkruan ai, - kurrë nuk mund të shikohet e vërteta." I tërë libri argumenton shkencërisht ekzistencën e Zotit dhe na thotë se udhëzimin mund ta marrim vetëm nga Zbulesa e Zotit, nga Kur'ani.

"Kur'ani nuk është as zbulim imi", shkruan Hafiz Ismet Dibra, "e as thënia ime: çdo lexues e studiuës serioz i Kur'anit ka kuptuar se sa më shumë që ecën në leximin e studimin e tij, aq më shumë do të gjejë (me një gëzim të brendshëm) se si ky kuptim i përgjithshëm rritet duke u rritur aftësia e tij për t'i rrokur gjërat. Është si rasti i një alpinisti që, sa më lart ngjitet në mal, aq më larg sheh..."

Pushtuesit fashistë dhe ata gjermanë, më vonë, i ofruan ofiqe dhe dekorata, por ai, ashtu si më 1919 që nuk pranoi postin e profesorit të katedrës nga Turqia, edhe kësaj radhe nuk pranoi asnjë dekorim, as post. Pushteti komunist, të cilit ai nuk iu nënshtrua, e arrestoi në 1946 në moshën 60-vjeçare dhe e dënoi pa asnjë arsye, por vetëm për bindjet e tij fetare, me 12 vjet heqje lirie, të cilat i bëri si shumë e shumë të tjerë në burgjet e diktaturës komuniste. Kështu u dënuan edhe shumë hoxhallarë të tjerë nga diktatura komuniste, siç ishin Hafiz Ali Korça, Hafiz Mustafa Varoshi, Hafiz Sherif Langu, Hafiz Musa Dërguti, Hafiz Ali Kraja, e shumë fetarë, dijetarë e atdhetarë të tjerë...

Hafiz Ismet Dibra ndërroi jetë në Tiranë në vitin 1955, në moshën 69 vjeçare, duke mbetur shembull frymëzimi për botën shqiptare.¹

1. Për më tepër shih: gazeta "Drita Islame", nr. 3, 1992: 3; nr. 111, 1997: 2-4.

TË MIRAT SHËNDETËSORE TË AGJËRIMIT



Muslimanët anekënd botës kryejnë në këtë muaj agjërimin. Ata nuk e bëjnë këtë për të rënë në peshë apo për përfitimet shëndetësore, por sepse agjërimi urdhërohet në Kur'an:

"Oju qe keni besuar! Agjërimi ju është bërë obligim ashtu siç u ishte bërë atyre para jush (hebrenjtë dhe të krishterët), ashtu që të vetëpërbaheni dhe të përmirësoheni." (2:183)

Ushqimi i nevojitet trupit për të siguruar energjinë e nevojshme për aktivitetet ditore dhe kjo realizohet nga djegia e karbohidrateve që është sheqeri. Sasia e tepërt e karbohidrateve, e cila nuk përdoret, do të depozitohet në formën e glikogjenit dhe të yndyrës në muskuj dhe mëlçi, që të përdoret kur ka nevojë. Insulina, një hormon i pankreasit, ul nivelin e sheqerit në gjak dhe e depoziton atë si glikogjen.

Gjatë agjërimit marrja e karbohidrateve bie në mënyrë drastike duke ulur kështu nivelin e glukozës dhe të insulinës në gjak. Kjo bën që glikogjeni të shpërbëhet nga mëlçia dhe yndyrat të shpërbëhen nga indi dhjamor për të siguruar glukozë dhe acide yndyrore për energjinë e nevojshme gjatë ditës.

Disa nga dobitë shëndetësore të agjërimit gjatë Ramazanit janë:

Pushim për sistemin tretës. Është një e vërtetë e pranuar dhe e mbrojtur nga autoritetet mjekësore se sistemi i tretjes që fillon të funksionojë sapo të vijë në botë, ka nevojë të pushojë herë pas here. Dobia e agjërimit, i cili është pushim i trupit një muaj në vit, me këtë aspekt të tij për trupin e njeriut, nuk mund të mohohet. Ramazani është një periudhë pushimi për sistemin tretës, i cili është përgjegjës për tretjen dhe thithjen e ushqimit. Për pasojë, edhe mëlçia, e cila është fabrika e metabolizmit, gjithashtu pushon gjatë kësaj kohe. Për të arritur këtë përfitim, agjëruesi duhet t'i përmbahet porosisë profetike që thotë të hahet shumë në syfyr dhe më pak në iftar. Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Biri i Ademit nuk ka mbushur një enë më të keqe sesa stomakun e tij. Vetëm disa kafshata janë të mjaftueshme për të thyer urinë. Më e mira është të mbushet 1/3 e stomakut me ushqim, 1/3 me ujë dhe 1/3 me ajër". Është e këshillueshme që çelja e iftarit të bëhet me hurma (arabe) si një traditë profetike. Hurmat janë të pasura me glukozë dhe fruktozë, të cilat kanë kalori të shumta veçanërisht për trurin, rrisin nivelin e glukozës në gjak gradualisht duke pakësuar urinë dhe nevojën për shumë ushqim.

Rënie e moderuar në peshë. Gjatë agjërimit ulet konsumimi i sheqernave dhe po ashtu edhe niveli i tyre në gjak. Kjo bën që organizmi të konsumojë sheqernat e depozituar në mëlçi dhe muskuj për të përballuar nevojat metabolike. Glikogjeni i depozituar në mëlçi dhe yndyrat në lëkurë dhe organe shpërbëhen dhe konsumohen për energjinë ditore. Kjo rezulton në rënie të peshës trupore. Prandaj, agjërimi konsiderohet me shumë vlerë për personat mbipeshë dhe për diabetikët jo insulinë vartës të pastabilizuar.

Ulje e nivelit të kolesterolit në gjak. Shumë studime kanë vërtetuar se niveli i kolesterolit në gjak gjatë agjërimit si dhe depozitimi i tij në arterie ulen në mënyrë të dukshme. Kjo nga ana tjetër zvogëlon mundësinë për atak kardiak dhe cerebrovaskular dhe parandalon rritjen e presionit arterial. Ulja e yndyrave në gjak gjithashtu ndihmon tretjen e gurëve në fshikëzën e tëmthit dhe tubin koledok. Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Agjëroni, që të jeni të shëndetshëm."

Pushim për veshkat. Shumë studime kanë treguar se mospirja e ujit për 10-12 orë nuk është aspak e dëmshme, përkundrazi, ka shumë përfitime. Përqendrimi i lëngjeve në trup shkakton dehidrim të lehtë, të cilin organizmi e përballon mirë, sepse ka një rezervë të mjaftueshme lëngjesh dhe për sa kohë nuk ka gurë, të dyja veshkat pushojnë nga aktiviteti i përditshëm i eliminimit të lëndëve toksike. Suneti i Profetit a.s. na këshillon që syfyri të shtyhet sa më vonë, ndërsa iftari të mos vonohet në mënyrë që të zvogëlohet sa më shumë të jetë e mundur koha e dehidrimit. Mosmarrja e lëngjeve çon në rënie të moderuar të presionit arterial dhe mund të jetë me përfitim për ata që vuajnë nga hipertensioni arterial.

Detoksifikim i trupit

Përveç të qenët i mirë për pastrimin e shpirtit, agjërimi vepron gjithashtu edhe si detoksifikant shumë efektiv për trupin. Duke mos ngrënë dhe pirë gjatë ditës trupi do të ketë rastin e rrallë të detoksifikojë (largojë helmet) nga sistemi tretës përgjatë gjithë muajit. Kur trupi fillon të konsumojë nga rezervat e dhjavit për të krijuar energji, në të njëjtën kohë do të djegë materialet toksike të dëmshme që mund të jenë prezente në depozitat e dhjavit (yndyrës). Ky pastrim trupi do të lërë një trup të shëndetshëm prapa dhe është një hap jashtë mase i rëndësishëm për vazhdimësinë e një jete të shëndetshme.

Pakësimi oreksit

Njëri nga problemet kryesore me dieta të

ndryshme është se pesha e humbur gjatë dietës fitohet shpejt pas saj, e nganjëherë madje edhe më shumë se ajo që është humbur. Kjo nuk ndodh me Ramazanin. Reduktimi në konsumin e ushqimit gjatë agjërimit bën që stomaku gradualisht të tkurret, që do të thotë se do ju duhet të hani më pak ushqim për t'u ndier i/e ngopur. Nëse doni të krijoni një zakon të ushqyerit të shëndetshëm atëherë Ramazani është momenti i duhur për t'ia filluar. Kur të përfundojë Ramazani, oreksi do të shuhet dhe të jetë më i pakët se më parë dhe kështu do të keni shumë pak gjasa ta teproni në të ngrënë.

Tranzicion i butë

Meqë agjërimi zgjat nga agimi në perëndim të diellit, lëndët ushqyese të organizmit zëvendësohen çdo iftar dhe syfyf. Kjo gjë siguron një tranzicion të butë nga përdorimi i glukozës si burim kryesor i energjisë deri te përdorimi i yndyrës duke parandaluar përdorimin e proteinave muskulare për metabolizmin.

Përdorimi i yndyrës për energji ndihmon rënien në peshë. Ajo ruan muskujt nga konsumimi dhe ul nivelin e kolesterolit në gjak. Për më tepër, rënia në peshë rezulton në një kontroll më të mirë të diabetit dhe të hipertensionit arterial.

Ndodh gjithashtu një proces detoksifikimi, sepse toksinat që janë të depozituara në indin dhjamor treten dhe eliminohen nga organizmi.

Pas disa ditësh agjërimi, vihen re nivele më të larta të endorfinave në gjak, të cilat na bëjnë më të lumtur dhe na japin një ndjesi mirëqenieje të përgjithshme mendore e fizike.

Midis dy ditëve agjërimit njëra pas tjetrës është e rëndësishme një dietë e ekuilibruar ushqimi dhe lëngjesh.

Për të parandaluar tretjen e proteinave, vaktet duhet të përmbajnë sasi të mjaftueshme të karbohidrateve dhe yndyrave.

Pse nuk është i dëmshëm agjërimi?

1. Nëse e krahasojmë me dietat e tjera, agjërimi i Ramazanit nuk shkakton kequshqyerje apo marrje të pamjaftueshme të kalorive, sepse nuk ka

kufizim për llojin e ushqimit ose të pijes që do të përdoret në iftar dhe syfyf.

2. Agjërimi i Ramazanit bëhet në mënyrë të vullnetshme, nuk është një recetë mjekësore e dhënë nga mjeku. Në hipotalamus, në tru, gjendet një pjesë që quhet "lipostat", e cila kontrollon masën trupore. Në rastet kur kemi rënie të madhe dhe të shpejtë në peshë nga dietat drastike, kjo qendër nervore e percepton këtë ndryshim si jo normal, prandaj e riprogramon organizmin për të marrë përsëri dhe me shpejtësi peshën e humbur në momentin që dieta përfundon. Kështu që, mënyra më e mirë për të rënë në peshë është me ngadalë, e kontrolluar dhe graduale duke modifikuar mënyrën e të ngrënit. Ramazani, në terma të marrjes së ushqimit, është muaji i vetë-rregullimit dhe vetë-trajnitimit duke sjellë një ndryshim në funksionimin e lipostatit.

3. Gjatë Ramazanit nuk kemi ndonjë kufizim në llojin e ushqimit që do të konsumojmë. Syfyfi duhet të jetë më i bollshëm, ndërsa iftari këshillohet të çelet me diçka të ëmbël si p.sh. hurma arabe, në mënyrë që të mos hamë më shumë se ç'duhet më pas.

4. Pas namazit të jacisë gjatë këtij muaji është sunet të falet namazi i teravive dhe namazi i natës (tehexhud), i cili shërben në këtë rast si aktivitet fizik që ndihmon metabolizmin e ushqimit. Është llogaritur se gjatë faljes së 20 rekateve teravi harxhohen rreth 200 kalori.

5. Agjërimi i Ramazanit është një ushtrim i vetë-disiplinimit. Për duhanpirësit e rregullt apo ata që kanë varësi nga një ushqim ose nga një pije e caktuar si p.sh. kafeja, agjërimi është një mënyrë e mirë për të thyer zakonin duke shpresuar që efekti do të vazhdojë edhe pas agjërimit.

6. Efektet psikologjike të Ramazanit janë të mirënjohura dhe të vërtetuara nga shumë agjërues në mbarë botën. Ata tregojnë për një ndjenjë paqeje dhe qetësie të brendshme. Profeti a.s. ka

këshilluar: "Nëse dikush ju ngacmon me fjalë apo me gjeste agresive, thojini: unë jam në agjërim". Prandaj armiqësia gjatë këtij muaji është minimale dhe pothuajse inekzistente.

Nga përvoja e shumë besimtarëve kemi të dhëna se brenda ditëve të para të agjërit personi fillon të ndjehet më mirë fizikisht, madje pa rënë akoma në peshë asnjë gramë. Ata punojnë dhe luten më shumë. Vullneti dhe freskia mendore përmirësohen dukshëm. Shumë besimtarë kontrollojnë nivelet e glicemisë, kolesterolit, triglicerideve përpara Ramazanit dhe pas tij duke vërtetuar një përmirësim të këtyre parametrave në fund të agjërit. Megjithëse disa nuk janë mbipeshë, rënia në shumicën e rasteve është minimale dhe rikuperohet shpejt më pas. Agjërimi në Ramazan do të jetë një bekim i madh dhe një mundësi për të mos u humbur për ata që duan t'u largohen veseve si duhanpirja, alkoolizmi etj.

Agjërimi për disa pacientë në trajtim mjekësor

Siç dihet tashmë, personat e sëmurë dhe në trajtim mjekësor nuk e kanë obligim agjërimin, por disa prej tyre kanë vendosur të agjërojnë. Sugjerimet e mëposhtme nga ekspertë të kësaj fushe janë shumë të dobishme dhe të këshillueshme për t'u ndjekur.

1. Pacientët diabetikë: Diabetikët, të cilët janë pa mjekim dhe e kontrollojnë sëmundjen vetëm me dietë, mund të agjërojnë. Duke agjëruar, ata do të kenë nivele më të ulëta të glukozës në gjak dhe duke rënë në peshë, ata do të kenë një përmirësim të dukshëm të sëmundjes së tyre duke shmangur intolerancën ndaj glukozës dhe rezistencën ndaj insulinës. Diabetikët, të cilët mjekohen me barna hipoglicemiantë nga goja, duhet të jenë shumë të kujdesshëm nëse vendosin të agjërojnë. Ata duhet të përdorin 1/3 e dozës së ilaçeve si dhe t'i marrin ato në kohën e iftarit dhe jo në syfyr. Nëse gjatë ditës të këta pacientë zhvillohen shenjat e rënies së nivelit të glukozës në gjak si: uri e thellë, ndjenjë të fikëti, djersë të ftohta etj., ata duhet ta ndërpresin menjëherë agjërimin. Diabetikët që marrin insulinë nuk duhet të agjërojnë. Nëse dikush

vendos të agjërojë ndonjë nga ditët, duhet të marrë përsipër rrezikun dhe ta kryejë agjërimin nën kujdes të rreptë mjekësor duke bërë ndryshimet e duhura të dozës së insulinës. Për shembull, duhet të eliminohet insulina me veprim të shkurtër dhe të përdoret vetëm insulina Lantus pas iftarit ose para syfyr. Të gjithë diabetikët që vendosin të agjërojnë duhet të ndjekin dietën diabetike në iftar dhe në syfyr. Sidoqoftë, ëmbëlsirat nuk janë të dobishme për ta edhe nëse kanë agjëruar. Së fundi, të mos harrohet të matet niveli i glukozës në gjak dy herë në ditë me glukometër.

2. Pacientët hipertensivë ose kardiakë: Ata që kanë hipertension të lehtë ose të moderuar, sidomos nëse janë mbipeshë, duhet të nxiten që të agjërojnë, sepse agjërimi në këtë rast do të ndihmojë në uljen e presionit të lartë të gjakut. Përpara kësaj, ata duhet të këshillohen me mjekun e tyre për të rregulluar dozën e ilaçeve që do të marrin. Për shembull, doza e diuretikut (shkarkuesit) duhet të ulet nga frika e dehidrimit dhe barnat që merren një herë në ditë si Amlodipina duhet të merren para syfyr. Pacientët me hipertension të pakontrolluar dhe ata me sëmundje të zemrës nuk duhet të agjërojnë.

3. Pacientët me dhimbje koke ose migrenë: Si në dhimbjen tensive të kokës ku dehidrimi ose niveli i ulët i glukozës në gjak mund të përkeqësojë simptomat edhe në dhimbjen migrenoze ka një precipitim dhe përkeqësim të simptomave si pasojë e çlirimit të katekolaminave. Për pasojë, pacientët me migrenë këshillohet të mos agjërojnë.

4. Gratë shtatzëna: Shtatzënia nuk është një sëmundje, por është një gjendje e veçantë dhe jo e lehtë për gruan. Në Kur'anin Famëlartë nuk ka një përjashtim për këtë por, Profeti Muhamed a.s. ka thënë që gratë shtatzëna ose ato që ushqejnë fëmijën me gjë të mos agjërojnë. Askush nuk mund të agjërojë përtej mundësive dhe askush nuk duhet të vuajë, as edhe një fetus në barkun e nënës. Kjo është nga mëshira e Krijuesit tuaj.

Erion Sukaj



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Sadakaja e Fitrit *dhe* Zekati



PayPal: @albaniakmsh

Banka Kombëtare Tregtare

NR. 110000709 | SWIFT: NCBAALTXXX

IBAN ALL: AL 14 2051 1014 0007 09CL TJCL ALLO

IBAN USD: AL 85 2051 1014 0007 09CL TJCF USDA

IBAN EUR: AL 41 2051 1014 0007 09CL TJCF EURA